# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5905
E mërkurë, 16 tetor 2019
çmimi 0.40 €


## BE-ja ende pa vendim për hapjen e negociatave me Shqipërinë dhe Maqedoninë

FAQE 2




Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de


FLET PËR "EPOKËN E RE", BEHAR SELIMI FAQE 4-5



# KOSOVA KISHTE PAK GJASA TË ANËTARËSOHET NË INTERPOL

Eksperti i sigurisë, Behar Selimi, ka bërë me dije se Kosova kishte pak gjasa që të bëhej anëtare e Interpolit këtë vit. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se veprimi i Qeverisë së Kosovës për t'u tërhequr nga votimi për anëtarësim në këtë organizatë ka qenë i natyrshëm. Sipas tij, dorëheqja e qeverisë ua ka pamundësuar institucioneve të vendit që të përgatiten si duhet për këtë anëtarësim. Ish-drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës ka treguar se Kosova nuk humbet shumë me mosanëtarësim në këtë organizatë ngaqë Policia e Kosovës tani ka bashkëpunim me të gjitha policitë e rajonit

# Specialja fton edhe tre ish-pjesëtarë të UÇK-së

FAQE 3



Fadil Beka, Fatmir Sopi dhe Sejdi Veseli janë tre të ftuarit e radhës nga Gjykata Speciale. Lajmin e ftesës së tyre për intervistim nga kjo gjykatë e ka bërë me dije kryetari i Organizatës së Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (OVL UÇK), Hysni Gucati. Ndonëse nuk ka treguar se në çfarë cilësie janë ftuar, si dëshmitarë apo të dyshuar, ai ka thënë se nga ky proces ata do të dalin faqebardhë. Gucati ka thënë se çdoherë do të jenë në mbrojtje të vlerave të luftës sepse, sipas tij, luftën e UÇK-së nuk mund ta njollosë askush

## 12 zyrtarët e KQZ-së të shtrirë në Infektivë janë në gjendje të mirë shëndetësore

FAQE 7



## OPINION

### KUSH VODHI VOTA DEPUTETËSH, ATJE? F. 6



Fadil MALOKU

### PETER HANDKE DHE GJYKATA SPECIALE F. 11

Arben HOXHA

## AKTUALE



### POLICIA NË KOSHARE GJEN DHE SHKATËRRON 4 050 BIMË NARKOTIKE F. 11

## EKONOMI

### RUKIQI THOTË SE PARTITË POLITIKE DUHET TË KENË STRATEGJI ZHVILLIMORE F. 8

### GJILANI SHPËRNDAN FARË GRURI PËR 940 FERMERË F. 9

## SPORT

### LLUMNICA: KOSOVA ISHTE SUPERIORE NDAJ MALIT TË ZI

F. 18




RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht –Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan , Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

## Cakaj: Bllokimi i negociatave zvogëlon rolin e BE në rajon

PRISHTINË, 15 TETOR - Para mbajtjes së takimit të ministrave të jashtëm të BE-së, për marrjen e vendimit nëse Shqipëria do të aderojë në familjen e madhe evropiane gazeta prestigjioze "Financial Times" i ka kushtuar një hapësirë mediatike çeljes së negociatave të anëtarësimit për Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut.
"Financial Times" i ka kushtuar një vëmendje të madhe asaj se çfarë është duke ndodhur në Luksemburg dhe asaj çfarë pritet të ndodhë në Bruksel lidhur me fatin e Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut. Në një artikull të saj evidentohet skepticizmi i Francës dhe i disa vendeve të tjera si Holanda apo Danimarka.
Në një prononcim për "Financial Times", ministri në detyrë për Evropën dhe Punët e Jashtme, Gent Cakaj është shprehur se bllokimi i negociatave do të sillte një ulje të rolit të BE-së në rajon.
Sipas Cakajt një ndërlikim i mëtejshëm i situatës do të sillte "ndarje" mes vendeve të cilat kundërshtojnë ndarjen e çështjeve të Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut dhe të tjerë që mendojnë se Tirana duhet të paguajë çmimin për avancimin e rastit të Maqedonisë - një këndvështrim që gjen mbështetjen edhe të diplomatëve - thuhet në shkrim.
"Franca e cila ka qenë skeptike rreth zgjerimit të BE-së, thekson se procesi i anëtarësimit duhet të rishikohet para se të shqyrtohet pranimi i vendeve të tjera, pasiguri kjo që ministri Cakaj e quan "dilemë false".



# BE-ja ende pa vendim për hapjen e negociatave me Shqipërinë dhe Maqedoninë

Në takimin e ministrave të jashtëm të Bashkimit Evropian nuk është arritur pajtimi për hapjen e negociatave të Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut, por në të njëjtin takim është vlerësuar se këto dy vende nuk mund të trajtohen të ndara



PRISHTINË, 15 TETOR - Ministrat e jashtëm të Bashkimit Evropian nuk kanë rënë dakord që Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut t'i hapen negociatat më 18 tetor.
Vendimi u bë publik nga Komisari i Zgjerimit, Johannes Hahn. Në përfundim të mbledhjes së ministrave të jashtëm të BE-së, Johannes Hahn deklaroi të martën se lajmet për hapjen e negociatave me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut nuk janë pozitive.
Ai deklaroi gjatë konferencës për mediet se BE-ja po jep një mesazh të gabuar për këto vende. "Jemi sërish ku ishim. Nuk është një moment për të cilin duhet të jemi krenarë. Është një moment që do të dëmtojë besueshmërinë tonë në Ballkanin Perëndimor", tha Hahn.
Komisari tha se ekziston edhe një mundësi që më 18 tetor, kur do të mblidhen krerët e qeverive dhe shteteve të BE-së, të merret një vendim final. Ai tha se çështja i kaloi Këshillit të BE-së, pa një vendim pozitiv, por duke shpresuar që deri më datën 18 të ketë një ndryshim qëndrimesh.
Komisari në ikje i KE-së deklaroi se nuk është arritur të gjendet një qëndrim i përbashkët mes vendeve të BE dhe shprehu keqardhjen për këtë. "Maqedonia e Veriut dhe Shqipëria i kanë plotësuar kushtet, jemi ne në BE që nuk po plotësojmë detyrimet tona", tha ai. Hahn shtoi se rreziku i mos hapjes së negociatave mund të krijojë hapësira që do shfrytëzohen nga faktorë të tjerë në Ballkanin Perëndimor.
Drafti i Presidencës finlandeze të Bashkimit Evropian për ndarjen e Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut nuk është pranuar nga ministrat e jashtëm të vendeve anëtare, të mbledhur në Luksemburg.
Ministrja finlandeze për Çështjet Evropiane, Tytti Tuppurainen, deklaroi se edhe propozimi për ndarjen e dy shteteve ballkanike, në procesin e negociatave, nuk u pranua.
Në konferencën e përbashkët me Johannes Hahn, Tytti Tuppurainen u shpreh optimiste se një marrëveshje do të arrihet në mbledhjen e së premtes së Këshillit Evropian.
Ministrja finlandeze saktësoi se janë disa shtete të BE-së që hezitojnë për hapjen e negociatave me Tiranën dhe Shkupin, ndërsa një vend, pa përmendur emër, është veçanërisht kundër.
Tytti Tuppurainen shprehu zhgënjimin që Këshilli nuk arriti sot në një vendim unanim për atë që e quajti "lagje të BE-së".

## Meta vlerëson partneritetin strategjik me Italinë



TIRANË, 15 TETOR - Presidenti i Republikës së Shqipërisë Ilir Meta priti të martën në një takim kryeministrin e Republikës së Italisë, Giuseppe Conte.
Meta vlerësoi partneritetin strategjik me Italinë dhe falënderoi për mbështetjen e vazhdueshme që Italia i ka dhënë Shqipërisë ndër vite në proceset e integrimit euro-atlantik të vendit.
Duke falënderuar për angazhimin konstant të Italisë në mbështetje të hapjes së negociatave të anëtarësimit të Shqipërisë në BE, presidenti Meta tha se "ndjekim me shumë vëmendje të gjithë debatin mbi vendimin që do të merret në Samitin që do të mbahet më 17 dhe 18 tetor për Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut. Shpresojmë që qasja realiste e çeljes në parim të negociatave, për Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut, të mbështetet nga të gjitha vendet anëtare".
Presidenti i Republikës vlerësoi faktin se Italia mbetet një nga partnerët kryesorë tregtarë të Shqipërisë. Gjithsesi, tha presidenti, ne konsiderojmë që ka ende shumë mundësi për t'u përdorur në intensifikimin e mëtejshëm të bashkëpunimit ekonomik dhe shkëmbimeve tregtare. Në veçanti, presim një prani më të madhe të investitorëve italianë në Shqipëri, tha ai.
"Një urë e fuqishme bashkëpunimi ndërmjet vendeve tona, janë edhe komuniteti arbëresh dhe emigracioni shqiptar në Itali. Presidenti inkurajoi që të rriten bashkërisht përpjekjet për mbajtjen gjallë të gjuhës, kulturës e traditave të pasura shqiptare në vendin fqinj", tha presidenti Meta.

EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

# Specialja fton edhe tre ish-pjesëtarë të UÇK-së



Fadil Beka, Fatmir Sopi dhe Sejdi Veseli janë tre të ftuarit e radhës nga Gjykata Speciale. Lajmin e ftesës së tyre për intervistim nga kjo gjykatë e ka bërë me dije kryetari i Organizatës së Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (OVL UÇK), Hysni Gucati. Ndonëse nuk ka treguar se në çfarë cilësie janë ftuar, si dëshmitarë apo të dyshuar, ai ka thënë se nga ky proces ata do të dalin faqebardhë. Gucati ka thënë se çdoherë do të jenë në mbrojtje të vlerave të luftës sepse, sipas tij, luftën e UÇK-së nuk mund ta njollosë askush

EPOKA E RE Shqipe HETEMI

Prishtinë, 15 tetor - Gjykata Speciale të martën ka ftuar për intervistim edhe tre ish-pjesëtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Në mesin e të ftuarve të radhës është edhe doktori që ka shërbyer në UÇK, Fadil Beka. Lajmin për këtë e ka bërë me dije kryetari i Organizatës së Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (OVL UÇK), Hysni Gucati, në llogarinë e vet në "Facebook". Ai ka thënë se çdoherë do të jenë në mbrojtje të vlerave të luftës sepse, sipas Gucatit, luftën e UÇK-së nuk mund ta njollosë askush. Ai ka thënë se doktori Beka duhet të ndihet krenar për veprimtarinë e vet gjatë dhe pas luftës në Kosovë. Sipas Gucatit, është i paharruar kontributi i tij në procesin e shtetformimit. "Mora lajmin që një ndër doktorët më të mirë që ishte në luftën e fundit në Kosovë dhe në radhët e UÇK-së, bashkëluftëtari im Fadil Beka, është ftuar nga Gjykata Speciale. Unë i them doktorit ndihu krenar me veprimtarinë tënde gjatë luftës, por edhe mbas luftës për kontributin në shtetformimin e Kosovës. Çdoherë do të jemi përkrah dhe në mbrojtje të vlerave të luftës. Luftën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës nuk mund ta njollosë dhe ta gjykojë askush!", ka shkruar Gucati në "Facebook".

Në mbështetje të doktorit të UÇK-së ka dalë djali i veprimtarit të shquar të çështjes kombëtare, Ukshin Hotit, Andin Hoti. Ai ka thënë se pastërtinë e Fadil Bekës dhe të UÇK-së nuk ka gjykatë në botë që mund ta njollosë. "Pastërtinë tënde dhe të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës nuk ka gjykatë në botë që mund ta njollosë. Jam i nderuar që isha kolegu yt në Kuvend, doktor Fadil Beka", ka shkruar Hoti në llogarinë e vet në "Facebook".

Po të martën ftesë nga Gjykata Speciale kanë marrë edhe dy ish-pjesëtarë të UÇK-së, Fatmir Sopi dhe Sejdi Veseli. Ndonëse Gucati nuk ka treguar se në çfarë cilësie janë ftuar, si dëshmitarë apo të dyshuar, ai ka thënë se nga ky proces ata do të dalin faqebardhë. "Sapo mora lajmin që Gjykata Speciale ka dërguar ftesë për anëtarin e Kryesisë, njëherësh kryetarin e Degës së Prishtinës, Fatmir Sopi dhe veteranin e UÇK-së, Sejdi Veseli. Të gjithë ata që janë të ftuar do të dalin faqebardhë", ka shkruar Gucati në llogarinë e vet në "Facebook".

Deri më tani Gjykata Speciale ka ftuar për intervistim dhjetëra ish-luftëtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, në mesin e tyre edhe figurat kryesore Ramush Haradinaj, Sylejman Selimi, Bislim Zyrapi, Sami Lushtaku, Sokol Dobruna, Rrustem Mustafa, Jakup Krasniqi, Sokol Bashota, Shukri Buja, Naim Maloku, Nazif Mehmeti, Blerim Kuçi, Time Kadrijaj, Lahi Brahimaj, Safete Hadergjonaj dhe ish-pjesëtarë të tjerë.

Gjykata Speciale u formua pasi deputetët e Kuvendit të Kosovës në gusht të vitit 2015 votuan për themelimin e saj. Formimit të Gjykatës Speciale i parapriu një rezolutë në Këshillin e Evropës që kërkonte hetime mbi supozimet e senatorit zviceran Dick Marty, i cili pretendonte se pjesëtarë të UÇK-së kanë kryer krime lufte dhe kanë trafikuar organe të serbëve të vrarë gjatë luftës në Kosovë.

## Bahtiri viziton nxënësit e shkollës teknike pas dyshimit për helmimin e tyre

Mitrovicë, 15 tetor (ER) - Kryetari i Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, së bashku me drejtorin e Arsimit, Egzon Jashari, pasi kanë marrë lajmin për dyshimin mbi helmimin e disa nxënësve në Shkollën Teknike "Arkitekt Sinani", menjëherë kanë vizituar ata në Spitalin Rajonal "Dr. Sami Haxhibeqiri".

Nga personeli mjekësor kryetari Bahtiri u njoftua rreth gjendjes shëndetësore të tyre, me ç'rast u konstatua se simptomat e tyre nuk tregonin për diçka shumë shqetësuese ku, pas trajtimit mjekësor, nxënësit janë liruar. Me këtë rast, kryetari Bahtiri u ka uruar nxënësve shërim sa më të shpejtë, duke thënë se çdo gjë e rëndësishme ka të bëjë pikërisht me shëndetin e fëmijëve tanë, po ashtu ai falënderoi edhe stafin mjekësor për kujdesin ndaj tyre.

Në vazhdim kryetari Bahtiri, së bashku me drejtorin Jashari dhe në prani të zyrtarëve të Policisë së Kosovës, kanë realizuar një vizitë në objektin e shkollës për të parë nga afër gjendjen faktike dhe mënyrën se si ka rrjedhur dyshimi mbi helmimin e këtyre nxënësve.



Flet për "Epokën e re", Behar Selimi

# Kosova kishte pak gjasa të



Eksperti i sigurisë, Behar Selimi, ka bërë me dije se Kosova kishte pak gjasa që të bëhej anëtare e Interpolit këtë vit. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se veprimi i Qeverisë së Kosovës për t'u tërhequr nga votimi për anëtarësim në këtë organizatë ka qenë i natyrshëm. Sipas tij, dorëheqja e qeverisë ua ka pamundësuar institucioneve të vendit që të përgatiten si duhet për këtë anëtarësim. Ish-drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës ka treguar se Kosova nuk humbet shumë me mosanëtarësim në këtë organizatë ngaqë Policia e Kosovës tani ka bashkëpunim me të gjitha policitë e rajonit

EPOKA E RE Muhamet KOCI

**Prishtinë, 15 tetor** - Eksperti i sigurisë, Behar Selimi, e ka vlerësuar të natyrshëm veprimin e qeverisë në dorëheqje për shtyrjen e votimit të Kosovës për anëtarësim në Interpol për vitin e ardhshëm. Ai ka bërë me dije se rrethanat e krijuara pas dorëheqjes së qeverisë kanë minimizuar gjasat e Kosovës për t'u bërë anëtare e Organizatës Ndërkombëtare të Policisë.

Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ish-drejtori i përgjithshëm i Policisë së Kosovës ka thënë se ndikimi i Serbisë dhe Rusisë në Asamblenë e Përgjithshme të Interpolit vazhdon të mbetet i madh. "Nuk ka pasur gjasa, meqë raporti i forcave në vendimmarrjen e Asamblesë së Interpolit nuk ka ndryshuar. Aty vazhdon të ketë ndikim Serbia dhe shtetet aleate të saj, në krye me Rusinë dhe Kinën. Ndërkohë që miqtë tanë, për arsye të ndryshme, nuk e kanë pasur prioritet këtë çështje për ne", ka thënë Selimi.

Ai ka kritikuar ofensivën diplomatike të Serbisë për ta penguar në çdo mënyrë anëtarësimin e Kosovës në këtë organizatë, duke bërë presion te shtetet e tjera. Sipas Selimit, me këtë qasje destruktive të Serbisë duhet të merret bashkësia ndërkombëtare ngaqë, sipas tij, institucionet e Kosovës nuk kanë mundësi. "Ne për këtë çështje nuk kemi shumë mundësi të ndikimit në sjelljen e Serbisë, por bashkësia ndërkombëtare po. Asaj mund t'ia kujtojmë detyrimet nga marrëveshjet paraprake dhe se nëse dëshiron marrëveshje përfundimtare me ne, duhet sjellje tjetër", është shprehur Selimi.

Duke folur për ndikimin rajonal të mosanëtarësimit të Kosovës në këtë organizatë, ish-drejtori i policisë ka thënë se Kosova nuk humbet shumë. Ai ka treguar se deri më tani Policia e Kosovës ka bashkëpunim shumë të ngushtë me të gjitha policitë e rajonit, me përjashtim të asaj të Serbisë. "Nuk humbet shumë, meqë Kosova, më saktë Policia e Kosovës, në fushën e parandalimit dhe luftimit të krimit, me përjashtim me Serbinë, ka bashkëpunim profesional me të gjithë. Megjithëkëtë, anëtarësimi do të krijonte raporte edhe më profesionale dhe vendi ynë do të ishte i barabartë si në informacione, po ashtu edhe në vendimmarrje për luftimin e krimit në nivel ndërkombëtar", ka thënë Selimi.

Më tej, ai ka vlerësuar se anëtarësimi i Kosovës në Interpol është i rëndësishëm, por jo i domosdoshëm dhe jo i rëndësisë vitale për vendin. Sipas Selimit, Policia e Kosovës duhet ta vazhdojë bashkëpunimin bilateral policor me shtetet anëtare dhe duhet të synojë krijimin e raporteve të reja me shtetet e tjera.

**"Epoka e re":** *Z. Selimi, qeveria në dorëheqje, e rekomanduar nga Ministria e Punëve të Jashtme, ka kërkuar shtyrjen e votimit të Kosovës për anëtarësim në Interpol për vitin e ardhshëm. Si e keni parë këtë veprim të qeverisë?*

**Selimi:** Vendim i natyrshëm karshi gjasave të vogla për anëtarësim. Në muajt që lamë pas, me drejtues politikë në dorëheqje dhe me prioritete të tjera, anëtarësimi në Interpol as që ka qenë temë e lëre më prioritet. Prandaj, e konsideroj vendim oportun me rrethanat.

**"Epoka e re":** *Sa mendoni se ka pasur gjasa Kosova që të anëtarësohet këtë vit në këtë organizatë?*

**Selimi:** Nuk ka pasur gjasa meqë raporti i forcave në vendimmarrjen e Asamblesë së Interpolit nuk ka ndryshuar. Aty vazhdon të ketë ndikim Serbia dhe shtetet aleate të saj, në krye me Rusinë dhe Kinën. Ndërkohë që miqtë tanë, për arsye të ndryshme, nuk e kanë pasur prioritet këtë çështje për ne.

# anëtarësohet në Interpol



**"Epoka e re":** *Në anën tjetër, Serbia prej kohësh ka nisur lobimin kundër anëtarësimit të Kosovës në Interpol. Cila do të dihej të ishte përgjigjja e institucioneve tona dhe bashkësisë ndërkombëtare ndaj Serbisë?*
**Selimi:** Ne, për këtë çështje, nuk kemi shumë mundësi të ndikimit në sjelljen e Serbisë, por bashkësia ndërkombëtare po. Asaj mund t'ia kujtojmë detyrimet nga marrëveshjet paraprake dhe se, nëse dëshiron marrëveshje përfundimtare me ne, duhet sjellje tjetër.

**"Epoka e re":** *Sa po humb rajoni me mosanëtarësimin e Kosovës në Interpol?*
**Selimi:** Nuk humbet shumë, meqë Kosova, më saktë Policia e Kosovës, në fushën e parandalimit dhe luftimit të krimit, me përjashtim me Serbinë, ka bashkëpunim profesional me të gjithë. Megjithëkëtë, anëtarësimi do të krijonte raporte edhe më profesionale dhe vendi ynë do të ishte i barabartë si në informacione, po ashtu edhe në vendimmarrje për luftimin e krimit në nivel ndërkombëtar.

**"Epoka e re":** *Cilat janë përgatitjet që duhet t'i ndërmarrin institucionet e Kosovës për vitin e ardhshëm për anëtarësim në Interpol?*
**Selimi:** Anëtarësimi në Interpol është i rëndësishëm, por jo i domosdoshëm dhe jo i rëndësisë vitale për ne. Duhet vazhduar bashkëpunimin bilateral policor me shtetet anëtare, madje duhet synuar edhe krijimi i raporteve të reja me shtetet e tjera. Ndihmën më të madhe për këtë objektiv kombëtar mund të na japin miqtë tanë. Mos t'i harrojmë edhe shtetet në rajon, madje asnjë shtet sado i vogël të na duket. Dhe për këtë nuk ka nevojë shpenzime të mëdha.

## Kosova tërhiqet nga votimi për anëtarësim në Interpol




PRISHTINË, 15 TETOR - Kryeministri në largim, Ramush Haradinaj, ka kërkuar shtyrjen e votimit të Kosovës për anëtarësim në Interpol për vitin e ardhshëm. Këtë vendim ai e ka marrë për shkak të rrethanave të krijuara si dhe bazuar në rekomandimin e MPJ-së. "Kryeministri në detyrë i Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj, duke marrë parasysh rrethanat e krijuara, bazuar në kompetencat si kryeministër në detyrë dhe nga rekomandimi i Ministrisë së Punëve të Jashtme, sot ka kërkuar shtyrjen e votimit të Kosovës për anëtarësim në Interpol për vitin e ardhshëm", është thënë në njoftimin e kryeministrisë.
Kosova kishte aplikuar për pranim në Interpol në janar të këtij viti dhe kërkesa e saj ishte pranuar nga Komitetit Ekzekutiv i Interpolit.
Kosova edhe këtë vit ia kishte mësyrë anëtarësimit në Organizatën Ndërkombëtare të Policisë (Interpol), Asambleja e Përgjithshme e së cilës mban punimet prej 15 deri më 18 tetor në Kili. Nikoqiri i sivjetmë i Asamblesë së Përgjithshme të kësaj organizate ditë më parë ua ka dërguar ftesat zyrtarëve të Kosovës për të marrë pjesë në takimin vjetor të 88 të vendeve të kësaj organizate.
Tentativat e Kosovës për anëtarësim në Interpol kanë nisur që nga viti 2010. Atë kohë Komiteti Ekzekutiv i kësaj organizate nuk e kishte marrë fare parasysh kërkesën e parashtruar nga Prishtina zyrtare. Më 2015 dhe 2016 Kosova kishte aplikuar, por nuk ishte futur në agjendën e Asamblesë së Përgjithshme. Më 2017 Kosova pati tërhequr vullnetarisht kërkesën për shkak të mbështetjes së pamjaftueshme.

## Ambasada e Gjermanisë i ofron mbështetje eksportit të prodhimeve vendore në Evropë



PRISHTINË, 15 TETOR (ER) - Ambasadori i Gjermanisë në Kosovë, Christian Held, gjatë një vizite të cilën ia ka bërë Komunës së Istogut dhe fermave të vogla, ka treguar se edhe Gjermania ofron mbështetje mbi dhjetëvjeçare për të ndihmuar në organizmin dhe planifikimin e fermave të vogla. Gjithashtu, sipas ambasadorit, thuhet se ky projekt mundëson të bëhet eksportimi i barishteve të thata, 95 për qind në Evropë. Përmes një postimi në llogarinë e vet në "Twitter" ambasadori gjerman ka treguar se 3 000 familje përmes më shumë se 300 fermave ofrojnë barishte në 58 pika grumbullimi në gjithë Kosovën. Pos të tjerash, ai është mahnitur se si ky projekt për planifikim ofron siguri për fermat e vogla nga një organizatë afatgjatë e shitjeve si dhe i bëri përshtypje vërtet ajo që mund të arrish me barishte dhe organizim të mirë.

# Kush vodhi vota deputetësh, atje?

## (Ose si i eliminoi ca eminenca për deputetë "lufta" e brendshme partiake?)



Fadil MALOKU

1. Zgjedhjet e sivjetme në Kosovë, sipas shumë parametrave ndërkombëtarë, ishin me standarde të larta, pra ishin për lakmi dhe përtej stadit të emancipimit politik të rajonit. Por, shtrohet pyetja, a ishin të tilla edhe në brendësi? Shumica e informacioneve, që tashmë janë duke arritur, pas numërimit të votave për subjekte politike, po dëshmojnë një konkurrencë tejet të ashpër jo midis subjekteve, por tani midis kandidatëve për deputetë që, ndryshe, shquhet edhe si "luftë brenda llojit".
2. Por çka e karakterizon këtë lloj "lufte" dhe përse zhvillohet me aq butësi të ashpër sociale? Arsyet duket se janë të shumta dhe pa dyshim se varen shumë nga shkalla dhe përvoja emancipuese e kandidatit. a). Egoizmi social që manifestohet brenda subjekteve politike, që në fillim u zhvillua kryesisht përmes ndarjes në grupe prej pesë kandidatësh, agjitimit ndërfamiljar e ndërfisnor, përhapjes së paragjykimeve dhe stereotipive për kundërkandidatët konkurrentë; b). xhelozia pasionante midis kandidatëve të vjetër (kontribuues të theksuar partiakë) dhe kandidatëve (parashutistë) të katapultuar nga korneri. Që nga kandidatët e vjetër perceptohen si jomeritorë apo të padenjë për të qenë para tyre kandidate serioze për listën e deputetëve; c). korruptimi i komisionarëve që e numëruan joprofesionalisht potencën e votave. Shumica e "gabimeve" (duket me qëllim) ishin nga këta komisionarë (B. Ramadani nga AAK-ja, B. Latifi nga PDK-ja, B. Luzha nga AAK-ja) që në zgjedhjet e 2017-s ca nga ta edhe u dënuan me vërejtje e gjobitje.
3. Fenomeni i "luftës së brendshme", shikuar me dioptrinë sociologjike, duket se është më shumë produkt i vonesës emancipuese sesa i ndonjë komploti të organizuar qëllimisht nga ndonjë subjekt i caktuar politik, apo ndonjë kandidat i caktuar që ka ambicie dhe qëllim final, abuzimin me votën e lirë qytetare. Kurse votat e ardhura nga Serbia, shlirë mund të trajtohen si masakrim dhe vjedhje industriale. Sepse, asnjë nen a kod ligjor nuk dëshmon se votimi i diasporës mund të bëhet nëpër ambasada apo vende të tjera ku mungon monitorimi... Zgjedhjet në Kosovë duket se ende janë veç një garë meskine për monopol dhe kryesisht ushtrohet përmes klanesh e grupesh klienteliste. Sepse i mungon elementi i garimit fisnik në ide, projekte e oferta konkrete për të mirën e shtetit dhe kombit.

# Komuna e Mitrovicës, UBT-ja dhe UN-Habitat-i nënshkruajnë marrëveshje bashkëpunimi

**Mitrovicë, 15 tetor (ER)** - Nënkryetari i Komunës së Mitrovicës, Faruk Mujka, ka pritur të martën në një takim rektorin e kolegjit privat UBT, Edmond Haziri, dhe përfaqësuesit nga UN-Habitat, në krye me këshilltaren teknike Gwendoline Mennetrier, me ç'rast është nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi në mes të tri palëve. Në këtë takim nënkryetari Mujka së bashku me përfaqësuesit nga UN-Habitat dhe UBT-ja janë pajtuar të bashkëpunojnë për bashkimplementimin e punëtorisë së dizajnit dhe zhvillimit urban të projektit për planifikim të bazuar në lagje në qytetin e Mitrovicës.

Qëllimi i këtij memorandumi është të sigurojë një kornizë bashkëpunimi brenda së cilës UN-Habitati, Komuna e Mitrovicës dhe UBT-ja do ta implementojnë së bashku punëtorinë e dizajnit dhe zhvillimit urban të NBPD-së.

Përmes këtij projekti punëtoria e dizajnit dhe zhvillimit urban për planifikim të bazuar në lagje do të mbledhë 25 studentë, me përgatitje të ndryshme akademike (duke përfshirë arkitekturën, planifikimin urban, mjedisin, sociologjinë dhe ekonominë), të cilët, në bashkëpunim me grupin punues bazë të projektit dhe komunitetet e lagjes, do të mblidhen për të shkëmbyer ide dhe për të sugjeruar skenarë zhvillimi hapësinor dhe socio-ekonomik.



Bashkëpunimi midis palëve në Mitrovicë do të implementohet me fokus në zhvillimin e një masterplani dhe programi për zhvillim socio-ekonomik për zonën e NBPD në kuadër të Punëtorisë së Dizajnit dhe Zhvillimit Urban.

Falë kësaj marrëveshjeje Komuna e Mitrovicës do të përfitojë përvoja profesionale dhe ide inovative nga ekspertët dhe studentët e fushave përkatëse për zgjidhjen e problemeve të komunitetit.

Nënkryetari Mujka, si dhe përfaqësuesit nga UN-Habitat-u dhe UBT-ja, janë pajtuar që bashkërisht do të ndërtojnë kapacitete institucionale dhe zhvillimore, teksa në muajt në vazhdim do të hartojnë projekte dhe programe të caktuara si pjesë e rëndësishme e marrëveshjes së bashkëpunimit.

# Policia në Koshare gjen dhe shkatërron 4 050 bimë narkotike



**Prishtinë, 15 tetor (ER)** - Policia e Kosovës, konkretisht zyrtarë policorë të Drejtorisë Rajonale të Policisë Kufitare Perëndimi Gjakovë, më 13 tetor kanë pranuar informacione se në rajonin e Koshares dyshohet se ka të mbjella bimë narkotike. Policia ka patrulluar atë zonë dhe ka arritur të gjejë pesë plantacione të mbjella me bimë që dyshohet të jenë narkotike.

Policia kufitare ka njoftuar Drejtorinë për Hetimin e Trafikimit të Narkotikëve, e cila, po ashtu, ka dalë në vendngjarje. Në atë rajon janë gjetur 4 050 bimë, gjatësia e të cilave ishte nga një metër deri në tri metra e gjysmë.

Policia ka shkulur dhe ka shkatërruar (djegur) bimët e gjetura në atë lokacion.

Për rastin është njoftuar Prokuroria për Krime të Rënda në Gjakovë dhe është iniciuar rasti 'kultivim i bimëve narkotike, substancave psikotrope dhe analoge'.

# 12 zyrtarët e KQZ-së të shtrirë në Infektivë janë në gjendje të mirë shëndetësore

Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës (ShSKUK), dr. Basri Sejdiu, ka vizituar të martën 12 zyrtarët e KQZ-së të shtrirë në Klinikën Infektive pasi janë përballur me një reaksion teksa kanë qenë duke numëruar zarfet me vota të ardhura nga Serbia në Kosovë. Ai ka theksuar se 12 pacientët janë në gjendje të mirë shëndetësore



EPOKA E RE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 15 TETOR - Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës (ShSKUK), dr. Basri Sejdiu, i shoqëruar nga prof. Naser Ramadani, drejtor i Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike dhe dr. Lindita Berisha, ushtruese e detyrës e drejtoreshës në Klinikën Infektive, kanë vizituar të martën 12 verifikuesit e KQZ-së të cilët janë të shtrirë në Klinikën Infektive.
Pas vizitës së tyre, drejtori Sejdiu ka thënë se 12 pacientët janë në gjendje të mirë shëndetësore. "Që nga fillimi trajtimi ka qenë i mirë dhe janë angazhuar dhe konsultuar të gjitha profilet e mjekëve dhe është formuar një konsilium mjekësor që ka mbikëqyrur rastet", ka thënë Sejdiu.
Prof. Naser Ramadani, drejtor i IKShP-së, ka thënë se nga e diela janë dërguar mostrat për analiza laboratorike për të konfirmuar apo jo sindromën infeksioze. "Këto analiza kanë ardhur dhe kanë rezultate të gjitha negative, nuk ka infeksion dhe pritet që në bazë të gjendjes së tyre të lirohen", u shpreh ai.
Prof. Ramadani ka theksuar se në bazë të rezultateve laboratorike nuk ka sëmundje ngjitëse. Drejtoresha e Klinikës Infektive, dr. Lindita Ajazaj-Berisha, ka thënë se 12 pacientët janë në gjendje të mirë shëndetësore dhe se shumë shpejt do të lirohen. Sipas saj, gjendja shëndetësore e tyre është e mirë.

## Autoritetet e Kosovës në kërkim të një laboratori për ekzaminimin e zarfeve nga Serbia

Prokuroria e Kosovës po i vazhdon hetimet në lidhje me zarfet me vota të ardhura nga Serbia pas raportimeve se më shumë se 20 zyrtarë të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kishin reaksione alergjike pas hapjes së zarfeve. Prej tyre, 12 kanë kërkuar ndihmë mjekësore dhe janë hospitalizuar.
Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Prishtinë, Kujtim Munishi, ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se deri më tani janë ndërmarrë të gjitha veprimet hetimore dhe se po priten rezultatet e analizave. "Sipas asaj që e kemi parë, kemi vendosur që këto analiza të bëhen jashtë vendit, prandaj është herët dhe çfarëdo që them, ndoshta mund të gaboj. Analizat duhet të bëhen jashtë vendit sepse nuk kemi një laborator i cili bën analiza të hollësishme ashtu siç po kërkohet tash", ka deklaruar Munishi.
Kryeprokurori Munishi nuk ka mundur të saktësojë se në cilin shtet do të dërgohen mostrat për analiza. "Është shumë herët, jemi duke punuar për të gjetur ku, por është shumë herët", është shprehur Munishi.
Për shkak të mungesës së rezultateve nuk dihet ende se si erdhi deri te paraqitjet e alergjisë te këta persona. Andaj, autoritetet në Prishtinë kanë paralajmëruar hetimin dhe ekzaminimin e mostrave.

# Mustafa informon ambasadorët e huaj për ecurinë e bashkëpunimit me LV-në për formimin e qeverisë

PRISHTINË, 15 TETOR (ER) - Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Isa Mustafa, ka pritur të martën në takime të ndara ambasadoren e Francës në Prishtinë, Marie-Christine Butel dhe ambasadorin britanik Nicholas Abbott. Me të dy ambasadorët Mustafa ka biseduar për zgjedhjet e 6 tetorit dhe për hapat për krijimin e institucioneve të reja.
Ambasadorja Butel dhe ambasadori Abbott e kanë uruar Mustafën për mbarëvajtjen e suksesshme të zgjedhjeve parlamentare. Ambasadori britanik ka shprehur interesimin e Mbretërisë së Bashkuar për përkrahjen e procesit të dialogut Kosovë - Serbi.
Ndërsa kryetari Mustafa të dy ambasadorët i ka njoftuar për vazhdimin e takimeve të grupeve punuese të LDK-së me ato të LV-së për përafrimin e programeve të të dy partive drejt një programi të përbashkët qeverisës. Ai ka bërë me dije se LDK-ja në qeverinë e ardhshme do të përqendrohet në funksionalizimin e shtetit ligjor, arsimit, shëndetësisë, integrimeve evropiane si dhe luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.
Po ashtu, kryetari Mustafa, duke falënderuar të dy ambasadorët për përkrahjen e shtetit të tij ndaj Kosovës në të gjitha sferat, ka potencuar domosdoshmërinë e vazhdimit të bashkëpunimit me Francën dhe Mbretërinë e Bashkuar.



# Rukiqi thotë se partitë politike duhet të kenë strategji zhvillimore

Kryetari i Odës Ekonomike (OEK), Berat Rukiqi, ka thënë se ndër prioritetet e qeverisë së ardhshme duhet të jetë rritja e eksportit dhe investimet në sektorin privat. Në një konferencë për media ai ka folur edhe për strategjinë zhvillimore, respektivisht të rritjes së eksportit, për të cilën gjë ka thënë se asnjë parti politike nuk ka prezantuar një strategji të mirëfilltë të rritjes së eksportit

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

**Prishtinë, 15 tetor** - Kryetari i Odës Ekonomike (OEK), Berat Rukiqi, në një konferencë për medie ka thënë të martën se Kosova ende përballet me mungesën e investimeve direkte dhe me një shkallë të lartë të papunësisë. Ai në këtë konferencë ka prezantuar edhe Gary Dirks, kryetar i bordit këshillëdhënës për sektorin privat në kuadër të OEK-ut. Rukiqi ka thënë se ky bord do të përbëhet nga ekspertë të huaj të cilët do të japin këshilla në sektorin e ekonomisë, arsimit dhe energjetikës.

Rukiqi ka theksuar se ndër prioritetet e qeverisë së ardhshme duhet të jetë rritja e eksportit dhe investimet në sektorin privat. "Në kohë zgjedhjesh sektori privat nuk ka ndonjë dinamikë. Ne jemi duke i bërë matjet se si kanë ndikuar zgjedhjet në biznes. Remitencat publike janë motorët kryesorë të rritjes ekonomike. Nëse nuk kemi investime private të rritjes të eksportit ne s'mund të kemi rritje ekonomike pa këto. Thërras qeverinë e re që, kur të flasë për rritjen ekonomike, paraprakisht të flasë se si bëhet rritja ekonomike. Prioritete të qeverisë së re duhet të jenë eksporti dhe investimet në sektorin privat. Ne ende jemi vendi me papunësinë më të lartë në regjion. Kemi problem me papunësi, pra ky problem është me ritme më të theksuara", është shprehur ai. Sipas Rukiqit, qeveria e re duhet ta vazhdojë reformën ekonomike dhe nuk duhet të ketë rritje të taksave pasi, sipas tij ndikon tek investitorët e brendshëm dhe të huaj. "Kompanitë tona për të qenë konkurruese duhet të dalin dhe të eksportojnë. Ne besojmë se këto janë tema që duhet të merret qeveria në ardhje dhe duhet të vazhdojë reforma ekonomike, dhe mos të ketë rritje të taksave pasi kjo është goditje për investitorët e brendshëm dhe të huaj. Këto janë temat me të cilat duhet të merret qeveria e re, por është me rëndësi mos të kemi rritje të taksave. Ne duhet ta mbajmë këtë politikë të taksave të ulëta. Duhet të kemi kujdes me investimet kapitale. Partitë politike kanë folur për eksportin, investimet e huaja dhe arsimin e dyfishtë, por nuk kanë treguar se si duhet t'i zbatojnë këto. Partitë kanë folur për gjëra që nuk na dërgojnë në një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik", ka deklaruar ai.

Rukiqi ka folur edhe për strategjinë zhvillimore, respektivisht të rritjes së eksportit, për të cilën ka thënë se asnjë parti politike nuk ka prezantuar një strategji të mirëfilltë të rritjes së eksportit. "Ne kishim deklarata nga zyrtarët e partive politike se kaq do të jetë rritja ekonomike, por nuk thoshin se cilat janë burimet që do të çojnë në rritje ekonomike. Po ashtu, zyrtarët e partive politike nuk kanë prezantuar strategji zhvillimore. Po të kishim për ta votuar ndonjërën strategji, nuk e di se cilën do ta votoja. Partitë politike tregojnë se si do të vijnë deri te rritja ekonomike dhe çdoherë do të duhej të kishin parasysh parakushtet siç janë: Sundimi i ligjit, luftimi i informalitetit, edukimi dhe investimi në energji", ka thënë Rukqi.

Gary Dirks, kryetar i bordit këshillëdhënës për sektorin privat në OEK, i cili, po ashtu, është edhe profesor në Arizona State University, ka theksuar se të rinjtë e Kosovës janë invatorë dhe mund të krahasohen me vendet e tjera gjë që, sipas tij, kjo përbën edhe kapacitet ekonomik për investime. Ai ka folur për ndërtimin e termocentralit "Kosova e Re". Dirks ka theksuar se nuk duhet të hiqet nga tavolina ky projekt, pasi Kosova ka kapacitete më të mëdha në energji. "Jam i bindur se Kosovës i duhen më shumë kapacitete për energji elektrike. Një mundësi që mund të realizohet janë edhe investimet solare. Duke e ditur se keni një termocentral të vjetër i cili duhet të mbyllet, Kosova nuk mund të heqë dorë prej termocentralit, pra nuk duhet ta largojë prej tavolinës një projekt si termocentrali 'Kosova e Re'", ka deklaruar Dirks.



# Gjilani shpërndan farë gruri për 940 fermerë

Gjilan, 15 tetor (ER) - Drejtoria e Bujqësisë në Gjilan ka shpërndarë të martën farë gruri për 940 fermerë, ose 140 mijë kilogramë. Kryetari i Gjilanit, Lutfi Haziri, ka deklaruar se baza për zhvillim ekonomik lokal mbetet bujqësia. "Unë i uroj 940 familjet bujqësore që po e mbajnë jetën gjallë në komunën tonë sepse bazë për zhvillim ekonomik lokal mbetet bujqësia. Në këtë rrafsh komuna ka vendosur që t'i subvencionojë bujqit. Uroj që këto mbjellje të sjellin bukë në sofrat tona më shumë, siguri më të madhe për familjen dhe lehtësim në punë. Krahas kësaj, do t'i rrisim subvencionet për zgjerimin dhe rritjen e pemëtarisë dhe perimtarisë", ka thënë Haziri.

Drejtori i Bujqësisë në Gjilan, Ramiz Ramadani, pasi ka falënderuar kryetarin Haziri për përkrahjen në sektorin e bujqësisë, ka njoftuar se vlera e projektit është rreth 50 mijë euro. "Është farë e varieteteve hungareze, e cila është testuar për një kohë të gjatë në tokat tona dhe është jashtëzakonisht e përshtatshme. Kemi bërë përpjekje të vazhdueshme që t'u sigurojmë fermerëve edhe mekanizëm, prandaj objektivi ynë është jo vetëm ta rrisim punimin e sipërfaqeve të tokës, por edhe produktivitetin, duke e përdorur potencialin gjenetik të farës dhe optimumin e përgatitjes së tokës", ka thënë Ramadani.

Drejtori i Bujqësisë në Gjilan ka njoftuar se janë në përgatitje edhe të projektit të ngritjes së 15 hektarëve me arra.





# Shqipëria heq tarifat për veturat elektrike

Tiranë, 15 tetor - Drejtoria Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor në Shqipëri do ta rimburësojë çdo tarifë të regjistrimit për herë të parë për mjetet elektrike plug-in. Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit të Transportit Rrugor, Blendi Gonxhja, ka informuar se tarifat e regjistrimit do të bëhen zero, kontrolli fizik do të kushtojë 1 500 lekë, leja e qarkullimit kombëtare bëhet 1 000 lekë, target standard do të jenë 3 000 lekë dhe certifikata e pronësisë do të kushtojë 2 000 lekë. "Në total, 7 500 lekë të reja për çdo mjet green do të mbulohen nga DPShTRR-ja", ka thënë Gonxhja.

Nisma bazohet në vendimin e Këshillit të Ministrave "Për planin kombëtar për menaxhimin e cilësisë së ajrit" që adreson cilësinë e ajrit si një ndër çështjet mjedisore më kritike që ka të bëjë me administratorët lokalë dhe autoritetet qendrore si dhe prek jetën e përditshme të çdo qytetari.

DPShTRR-ja bëhet kështu një ent promotor dhe protagonist edhe për risi konkrete për mbrojtjen e mjedisit dhe cilësisë së ajrit, uljen e ndotjes mes nxitjes së regjistrimit të mjeteve Green nga qytetarët si dhe ndërgjegjësimit për gjeneratat e së tashmes dhe së ardhmes. "Ky lajm i mirë e i gjelbër është vetëm një nga shumë nismat Green që DPShTRR-ja po përgatit për miratim në këshillin tonë drejtues dhe MIE, krahas propozimeve në kuadër të ndryshimeve në ligjin për taksat për mjetet rrugore, për miratim në MFE", është shprehur Gonxhja.

# Drejtues të Fakultetit Ekonomik organizuan takim me përfaqësues të bizneseve

Gjilan, 15 tetor (ER) - Fakulteti Ekonomik i Universitetit Publik të Gjilanit "Kadri Zeka" në Gjilan ka organizuar një takimin me përfaqësues të bizneseve që veprojnë në Anamoravë, në të cilin është diskutuar për të ardhmen e Fakultetit (programet studimore) dhe për mundësitë e bashkëpunimit dhe praktikës për studentët.

Dekani i Fakultetit Ekonomik, Xhevat Sopi, ka falënderuar pjesëmarrësit në takim e që ishin përfaqësues të bizneseve që veprojnë në Gjilan, kurse para tyre ka prezantuar hulumtimin e bërë me rreth 130 studentë të diplomuar të UKZ-së për të parë se si e kanë gjetur ata veten në tregun e punës pas studimeve dhe, po ashtu, ka prezantuar draft-planin për programet e reja studimore.




Kryetari i Bordit Industrial të Universitetit "Kadri Zeka", Xhelal Selimi, në fjalën e tij ka thënë se bizneset e Anamoravës duhet ta paraqesin interesimin e tyre dhe t'i drejtohen universitetit për kërkesat e studentëve për punë praktike sepse, siç ka thënë ai, për bizneset është shumë e rëndësishme ta kenë të sofistikuar teknologjinë e të cilën studentët e UKZ-së e njohin sepse e kanë studiuar shumë mirë.

Edhe përfaqësuesit e tjerë të bizneseve theksuan se Universiteti "Kadri Zeka" në Gjilan ka programe të mira të studimit mirëpo, sipas tyre, studentët kanë nevojë për punë praktike në mënyrë që t'i përvetësojnë njohuritë e fituara gjatë kohës së studimit, që do të thotë se ata duhet të dinë nga afër punën e prodhimit, zhvillimit dhe gjithçka tjetër që lidhet me prodhimin. Gjatë takimit, të pranishmit, pas disa diskutimeve, bënë sugjerimet e tyre për atë çfarë mund ta përmirësojë UKZ-në në vazhdim.

# Prej 19 tetorit deri më 31 dhjetor këto rrugë do të mbyllen për qarkullim në Prishtinë



PRISHTINË, 15 TETOR (ER) - Komuna e Prishtinës ka njoftuar qytetarët se nga data 19 tetor e deri më 31 dhjetor rrugët 'Arkitekt Karl Gega' dhe 'Ali Pashë Tepelena' do të jenë të mbyllura për qarkullim të automjeteve. "Prej ditës së shtunë, 19 tetor deri më 31 dhjetor 2019, rrugët 'Arkitekt Karl Gega' dhe 'Ali Pashë Tepelena' do të jenë të mbyllura për qarkullim të automjeteve, me qëllim të realizimit të punëve për intervenimin e rrjetit të kanalizimit. Punimet në këto dy rrugë janë pjesë e projektit dhe kontratës 'Rikonstruimi i rrugës 'Gazmend Zajmi', 'Ali Pashë Tepelena' dhe 'Arkitekt Karl Gega'", është thënë në njoftimin e Komunës së Prishtinës. Komuna e Prishtinës ka falënderuar qytetarët paraprakisht për mirëkuptimin dhe i ka lutur ata që gjatë kësaj kohe t'i shfrytëzojnë rrugët alternative për qarkullim në këtë pjesë të qytetit.

# Filloi rregullimi i rrugës 'Bill Klinton' në Malishevë

MALISHEVË, 15 TETOR (ER) - Në kuadër të rregullimit të infrastrukturës rrugore në qytetin e Malishevës kanë filluar punimet për rregullimin e rrugës "Bill Klinton" në lagjen Mirëdita. Punimet në këtë rrugë i ka parë nga afër kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, i cili ka thënë se gradualisht janë duke e kompletuar tërë infrastrukturën rrugore si në fshatra, po ashtu edhe në qytet. "Edhe pse nevojat lindin në vazhdimësi për shkak të rritjes së numrit të shtëpive, sidomos në qytet, ne si komunë jemi të obliguar që të gjithë banorëve t'ua sigurojmë infrastrukturën e nevojshme. Pas kësaj rruge do të vazhdohet edhe me rrugë të tjera si në këtë lagje, po ashtu edhe lagjet e tjera, në veçanti në lagjet e reja të cilat çdo ditë e më tepër po mbushen me banorë", ka thënë Begaj gjatë vizitës në këtë lagje.
Rruga "Bill Klinton" është e gjatë rreth 400 metra dhe rregullimi i saj, që përfshinë asfaltimin e saj, trotuaret dhe rregullimin e tërësishëm, mundësohet nga buxheti komunal i Malishevës.






# Familja e Remzi Gashit në Skenderaj bëhet me shtëpi

SKENDERAJ, 15 TETOR (ER) - Kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, ia ka dorëzuar çelësat e shtëpisë familjes së Remzi Gashit në lagjen III në Skenderaj. "Donator i kësaj shtëpie është bashkatdhetari ynë që jeton në Zvicër, Arben Dauti, të cilin e falënderoj në emër të komunës sonë për ndihmën që i ka ofruar kësaj familje. Falë ndihmës së njerëzve vullnetmirë çdo ditë e më shumë familjet nevojtare po bëhen me shtëpi", ka thënë kryetari Jashari.

# Haziri: Zona urbane e Gjilanit po bëhet zonë qarkullimi pa vetura

GJILAN, 15 TETOR (ER) - Nën udhëheqjen e kryetarit të Gjilanit, Lutfi Haziri, është mbajtur të martën mbledhja e bordit të drejtorëve, në të cilën është diskutuar lidhur me planifikimin e tremujorit të ardhshëm dhe për planifikimin në vitin 2020. "Pjesa më e madhe e investimeve do të vazhdojë në ndërtimin e fshatit model, për përmbylljen e investimeve infrastrukturore. Ndërsa zona urbane do të jetë prioritet i lartë i investimeve që përfshihet rregullimi i trotuareve dhe standardizimi për personat me nevoja të veçanta, për biçiklistët dhe për nënat me fëmijë. Qëllimi kryesor është që zonën urbane ta kthejmë në zonë qarkullimi pa vetura. Përfundimi i rregullimit të lumit Mirusha, Tregut të Gjelbër dhe punimet te Stadiumi i Qytetit janë projekte që eliminojnë nevojën e qarkullimit me vetura", ka thënë Haziri.
Duke folur për projektet infrastrukturore, Haziri ka pohuar se shumica e tyre tashmë janë të buxhetuara dhe po punohet me dinamikë të shtuar. "Ndërtimi i rrugëve regjionale tashmë është i buxhetuar, pritet që Banka Evropiane për Zhvillim në fund të këtij muaji t'i konfirmojë investimet në rrugën Gjilan - Prishtinë me gjatësi prej 7.2 kilometrash. Do t'i vazhdojmë investimet në rrugën Gjilan - Bujanoc, në rrugën e Kumanovës, në rrugën prej Livoçit të Ulët në drejtim të Kllokotit dhe rrugët e tjera që janë pjesë e investimeve. Kjo na jep lehtësim dhe krijon frymëmarrje që të kalohet në investime brenda zonës urbane", ka theksuar Haziri.
Prioritet kryesor për vitin e ardhshëm, i pari i gjilanasve ka thënë se është ndërtimi i impiantit të ujërave të zeza, i cili tashmë ka marrë rrugë dhe ratifikimi i marrëveshjes pritet të ndodhë në seancat e para të Kuvendit të Republikës.



# PETER HANDKE DHE GJYKATA SPECIALE

Arben HOXHA

Ndarja e çmimeve nuk është një akt i thjeshtë shpërblimi e nderimi për veprimtari të caktuar në jetën njerëzore. Çmimet përfaqësojnë vlerësimin e kritereve të një mënyre të caktuar të të ekzistuarit tonë në botë si qenie njerëzore; esencën, parimet dhe orientimin e asaj ekzistence. Çmimet janë aktualizim i ftesës që i bëhet vëmendjes së një komuniteti, apo edhe të mbarë njerëzimit, për t'u vendosur dhe për të qëndruar me konsistencë brenda një horizonti vlerash emancipuese. Çmimi Nobel për Letërsi, si një nga veprimtaritë më ingjoneze shpirtërore, sivjet i ndarë për një shkrimtar të njohur për angazhimin e tij politik me orientim fashist, Peter Handke, në fakt, është simptoma e gjendjes mendimore postdeontike, ku e bukura, e drejta dhe e vërteta, si kategori operacionale për përshkrimin, interpretimin dhe vlerësimin e realiteteve politike, shoqërore e kulturore të epokës sonë, trajtohen si entitete kategoriale krejtësisht të ndara e autonome dhe pa ndikim në njëra tjetrën, dhe, njëkohësisht, si kategori sinonimike (e jo dikotomike) me antipodet e tyre: të shëmtuarën, të padrejtën dhe të pavërtetën.

Politiciteti, si tipar substancial i ekzistencës së bashkësisë njerëzore, është nyja bashkuese që këto kategori i vë brenda një strukture unike të përpunuar mendimore e veprimore me qëllim të humanizimit të marrëdhënieve së njeriut kundrejt botës dhe të humanizimit të botës kundrejt njeriut. Depoliticiteti i këtyre kategorive është metodologjia e përveçimit dhe e politizimit të tyre. Depoliticiteti është instrument metodologjik me të cilin operon dhe i realizon synimet e veta pikëpamja parcialiste për botën. Depoliticiteti i drejtësisë është përpjekje për legjitimimin e padrejtësisë. Depoliticiteti i lirisë është përpjekje për legjitimim i shtypjes dhe robërisë. Depoliticiteti i të bukurës, është ftesë për indiferencë ndaj të vërtetës dhe të drejtës.

Arti buron nga politiciteti dhe është fryma e tij. Depoliticiteti është instrumenti më subverziv kundrejt qenies së artit, sepse ai e konteston idenë për bashkësinë (në kuptimin e gjerë të fjalës), të cilën provokueshëm e fton për realizim arti: depoliticiteti e konteston idenë e tërësisë së marrëdhënieve që njeriu ka me realitetet e ndryshme të qenies së vet dhe me të ngjashmit e vet, si dhe marrëdhëniet që ai ka me natyrën dhe me universin. Politiciteti është pikëmbështetja e universales. Depoliticiteti është pikëmbështetja e parciales. Politiciteti, për shkak se bazohet në pikëpamjen tëresiste për botën, buron nga arsyeja emancipuese dhe i shërben asaj. I prejardhur nga pikëpamja parcialiste, depoliticiteti buron dhe i shërben arsyes instrumentale. Depoliticiteti, si fuqi çmobilizuese e aftësive të njerëzores për të krijuar bashkësinë, për nevoja instrumetalizuese, e fton në ndihmë politikën, si filozofi praktike e organizimit të jashtëm të bashkësisë. Politiciteti, si fuqi që i ushqen aftësitë e brendshme të njerëzores brenda bashkësisë njerëzore, i shmang pengesat që i vendos politikja përmes politizimit të parciales me qëllim të pamundësimit të universales.

Çmimi Nobel, si vendim aksiologjik, në rastin e Peter Handke-s, e ndan veprën nga personaliteti i krijuesit të saj. Për ironi të fatit të njerëzimit, edhe Radovan Karaxhiçi ka shkruar poezi. Me kriteret e Akademisë Suedeze, edhe Radovani do të duhej të lirohej nga mbajta e dënimit, për shkak të "vlerës estetike" të poezive të tij. Reduktimi (në këtë rast jo fenomenologjik, por instrumentalist) i artit, i kuptimit të ekzistencës së tij, në mjetin e tij të jashtëm shprehës (gjuhë, ngjyrë etj.), është përpjekje për shfajësimin nga përgjegjësia që ai ka për fatin e ekzistencës së njeriut në botë.

Në rastin e ndarjes së Çmimit Nobel për Letërsi Peter Handke-s, e bukura, si entitet autonom në gjykimin estetik, del të jetë në sinkron dhe komplementare me të drejtën individuale për jetë si entitet autonom dhe parim i sistemit liberal të së drejtës ndërkombëtare. Gjykata Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë, për shkak se idenë e drejtësisë do ta bazojë në konceptin liberal të "së drejtës për jetë" të viktimave që pësojnë në luftëra, e jo në parimin luftërave të drejta e të padrejta (diferencimin e të cilës e bën të mundshme koncepti i lirisë kolektive e individuale në kushtëzimin e tyre reciprok), subjekt të vetin të drejtësisë do t'i ketë si viktimat (kroatët, boshnjakët, shqiptarët) ashtu edhe xhelatin e tyre (shtetin serb), dhe atë në një shpërndarje numerike proporcionale. Përkundër Gjykatës së Nurembergut, e cila do të përcaktojë qartë shkaktarin e veprimeve gjenocidale dhe viktimat që do të pësojnë prej atyre veprimeve, me ç'rast Gjermania do të jetë e shtrënguar t'i nënshtrohet procesit të denacifikimit, Gjykata Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë, të gjithë të përfshirët në "konflikt" do t'i trajtojë si bashkëfajtorë dhe bashkëvuajtës. Edhe pse shkaktare e katër luftërave, Serbia nuk do t'i nënshtrohet procesit të denacifikimit. Përkundrazi. Ajo do të trajtohet si faktor i rëndësishëm për stabilitetin e Ballkanit. Pse?

Gjykata e Nurembergut do të jetë themel dhe pasqyrim i "rendit botëror", i cili do ta mishërojë gjendjen statike të grupeve që veprojnë si trupa homogjen në bazë të një marrëveshjeje paraprake mes tyre. Gjykata Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë si dhe Gjykata Speciale do të jenë pasqyrim i botës së "ekuilibrit botëror", i cili, përkundër "rendit botëror", është mishërim i raportit dinamik midis forcave kundërshtuese në një sistem të hapur. Në botën e gjendjes së "rendit", kategoritë përshkruese, interpretuese dhe mirëmbajtëse të saj, janë në marrëdhënie hierarkike monolite; në botën e gjendjes së "ekuilibrit", kategoritë në veprimin njohës e vlerësues të tyre, shfaqen të shqendërzuar nga çfarëdo lloj strukture.

Në kontekstin e "rendit botëror" të pas Luftës së Dytë Botërore do të ishte e pamundur që një shkrimtar, mbrojtës i ideve nazifashiste ( me gjithë "vlera estetike" që, hipotetikisht, do të përmbante vepra e tij), të merrte Çmimin Nobel për Letërsi. Në kontekstin e botës së "ekuilibrit botëror" të pasrënies së Murit të Berlinit, një gjë e tillë është e mundur. Në kontekstin e "rendit botëror" të pas Luftës së Dytë Botërore (dhe jo vetëm) do të ishte pamundur të imagjinohej një Nuremberg kundër hebrenjve. Në Kontekstin e "ekuilibrit botëror", në emër të "pastrimit" të një Lufte Çlirimtare, me lehtësi të papërballueshme për asnjë fuqi imagjinate bëhet realitet ekzistenca e Gjykatë Speciale për krimet e supozuara të UÇK-së. Gjykata e Nurembergut është produkt i forcave aleate fituese të Luftës së Dytë Botërore; Gjykata Speciale është produkt i nevojave për stabilitetin e ekuilibrit midis forcave të superfuqive botërore konkurruese në luftën për zgjerimin e zonave të tyre të interesit. Gjykata Speciale është simptoma e mungesës së "rendit" të shoqërisë botërore. Për shkak se nuk do të funksionojë sipas konceptit të lirisë kolektive, Gjykata Speciale subjekt të së drejtës nuk do ta ketë luftën e UÇK-së në raport me shtetin gjenocidal të Serbisë, por në raport me popullatën vendore me përkatësi të ndryshme partiake e etnike, e cila supozohet të jetë viktimë e UÇK-së. Prej një përmbysjeje të tillë të logjikës së të drejtës dhe drejtësisë, Serbia do të synojë ta ndërtojë narracionin e vet moral se intervenimi i NATO-s ka qenë një gabim, se në Kosovë, si pjesë jugore e Serbisë, nuk ka pasur luftë mes ushtrisë së Serbisë dhe UÇK-së, porse aty ka ndodhur një luftë qytetare për pushtet midis UÇK-së terroriste dhe partive paqësore dhe minoriteteve etnike të pambrojtura; se ushtria e policia serbe ka ndërhyrë me qëllim që ta parandalojë dhe ta pamundësojë këtë luftë civile, por intervenimi i NATO-s ia ka pamundësuar këtë duke marrë një vendim të gabueshëm për largimin e Serbisë nga Kosova. Në vend se të dëbohet "fëmija problematik" (UÇK-ja me gjithë mbështetësit dhe përkrahësit e saj), NATO padrejtësisht e detyroi të dëbohet nga shtëpia - duke e larguar njëkohësisht nga "fëmijët e vet të mirë" - edhe vet "babën" (Serbinë administrative, ushtarake e policore). Në bazë të Rezolutës 1244 dhe, tash së fundi, në bazë të Gjykatës Speciale, "baba" ka të drejtë, fillimisht, legale dhe tash edhe morale të kthehet si zot shtëpie në shtëpinë e vet në Kosovë. Me pak fjalë, ky është narracioni, që, përmes Gjykatës Speciale, Serbia do të përpiqet t'ia rrisë vëllimin argumentimit për "të drejtën morale" dhe "domosdoshmërinë" e kthimit të saj në Kosovë. Ndërkaq, brenda Kosovës, subjektet konkurrente politike, duke përfituar nga goditja që do të marrë "krahu i luftës" prej Gjykatës Speciale, do të përpiqen të krijojnë "avantazhe morale" për rolin e tyre në historinë më të re të "çlirimit" dhe të "shtet-ndërtimit" të Kosovës. (Mjerim! Kaq është pika e lartësisë ku mund të arrijë steka e interesave meskine të vetëdijes tribaliste shqiptare!)

Çmimi Nobel për Letërsi i ndarë sivjet për Peter Handke-n është përmasa shpirtërore që e afirmon dhe e mirëmban stabilitetin e konceptit gjeopolitik të "ekuilibrit botëror", i cili është parimi i funksionimit dhe organizimit të jashtëm të shoqërisë botërore njerëzore. Autonomiciteti i të bukurës, si kriteri i brendshëm shpirtëror në gjykimin estetik për ndarjen e Çmimit Nobel për Letërsi, është në funksion komplementar dhe në unison me të drejtën për jetë të individit, si parim liberal i përveçuar nga koncepti i "luftërave të drejta dhe të padrejta" - me të cilin funksionoi dje Gjykata Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë dhe, tani, pritet të funksionojë Gjykata Speciale.

Në një botë ku, në njërën anë, pranohet si fakt i kryer dhe si faktor gjeopolitik një krijesë gjenocidale, siç është "Republika serbska" e Bosnje Hercegovinës, ndërsa, nga ana tjetër, krijuesit e saj trajtohen si "faktorë stabilizues të rajonit", duket krejtësisht i pafajshëm akti i ndarjes së Çmimit Nobel për Letërsi një shkrimtari, i cili, në njërën anë, me angazhimin e tij politik do të bëhet zëri mbështetës i një gjenocidi të tillë, ndërsa, nga ana tjetër, për "fatin e mirë të njerëzimit" (vetëm sa nuk na thanë edhe këtë!), i njëjti do të krijojë një letërsi që e "çliron njeriun nga çnjerëzorja brenda tij".





# ShBA-ja vendos sanksione ndaj Turqisë për shkak të ofensivës në Siri

Sekretari amerikan i Thesarit, Steven Mnuchin, njoftoi për vendosjen e sanksioneve, që përfshijnë Ministrinë e Mbrojtjes dhe të Energjisë, si dhe ministrat e Mbrojtjes, Energjisë dhe ministrin e Brendshëm. Masa parasheh ngrirjen e pasurisë së tyre në ShBA dhe ndalon transaksionet e lidhura me ShBA-në



Dominiqeu Jacovides (AFP)

**Uashington, 15 tetor** - Shtetet e Bashkuara kanë vendosur sanksione ndaj ministrive turke dhe zyrtarëve të lartë të qeverisë, në përgjigje të ofensivës ushtarake të vendit në veri të Sirisë. Ndërkohë, presidenti amerikan Donald Trump telefonoi homologun e vet turk, Rexhep Tajip Erdogan, për të kërkuar armëpushim të menjëhershëm, njoftoi nënpresidenti amerikan Mike Pence. Pence tha se ai do të udhëtojë në rajon për të diskutuar zhvillimet "sa më shpejt të jetë e mundur".

Masa e ShBA-së vjen pas kritikave për tërheqjen e trupave amerikane nga rajoni, që disa thonë se i dha Turqisë një dritë jeshile për ta nisur ofensivën.

Ndërhyrja ushtarake turke, e cila filloi javën e kaluar, synon t'i largojë nga rajoni kufitar Forcat Demokratike Siriane (SDF) të udhëhequra nga kurdët, raporton BBC.

Turqia e konsideron grupin e udhëhequr nga kurdët një organizatë terroriste.

Forcat turke, gjithashtu, duan të vendosin atë që qeveria e tyre e përshkruan si një "zonë e sigurt", për të rivendosur aty deri në dy milionë refugjatë sirianë që gjenden aktualisht në Turqi. Shumë prej tyre nuk janë kurdë dhe kritikët paralajmërojnë se kjo mund të çojë në spastrim etnik të popullatës lokale kurde.

Forcat e udhëhequra nga kurdët kanë qenë një aleat kryesor i ShBA-së në luftën kundër grupit militant, Shteti Islamik.

Kurdët e përshkruanin tërheqjen e ShBA-së, e cila i parapriu veprimit turk, si një "goditje pas shpine".

Ekziston frika se përshkallëzimi i konfliktit lokal mund të rrezikojë një ringjallje të IS-it, pasi mijëra ish-luftëtarë dhe të afërmit e tyre po mbahen në burgje në veri të Sirisë.

Disa qindra thuhet se tashmë kanë shpëtuar nga një kamp.

Turqia njoftoi më 14 tetor se forcat e saj e gjetën të boshatisur një burg ku mbaheshin militantët e Shtetit Islamik. Autoritetet turke nuk ishin në gjendje të tregonin sa të burgosur po mbaheshin në atë burg dhe as vendin ku kanë ikur.

Presidenti amerikan Donald Trump supozoi se forcat kurde me qëllim po i lirojnë të burgosurit, në mënyrë që ta detyrojnë rikthimin e trupave amerikane.

Përballë presionit të jashtëzakonshëm, forcat kurde njoftuan arritjen e një marrëveshjeje me Qeverinë siriane për mbështetje ushtarake në përballje me Turqinë.

Sekretari amerikan i Thesarit, Steven Mnuchin, njoftoi për vendosjen e sanksioneve, ndaj dy ministrive turke dhe tre zyrtarëve të lartë të qeverisë.

Sipas një deklarate, sanksionet përfshijnë Ministrinë e Mbrojtjes dhe të Energjisë, si dhe ministrat e Mbrojtjes, Energjisë dhe ministrin e Brendshëm. Masa parasheh ngrirjen e pasurisë së tyre në ShBA dhe ndalon transaksionet e lidhura me ShBA-në. "Veprimet e Qeverisë turke po rrezikojnë civilë të pafajshëm dhe destabilizojnë rajonin, përfshirë dëmtimin e fushatës për të mposhtur IS-in", thuhej në deklaratë.

Presidenti Donald Trump është përballur me presion në rritje për të ndërmarrë veprime kundër partnerit amerikan të NATO-s, përfshirë thirrjen edhe nga ligjvënësit republikanë, që zakonisht janë besnikë ndaj administratës së tij.

Në një deklaratë, presidenti Trump tha gjithashtu se ai do të rrisë tarifat për çelikun turk në 50 për qind dhe menjëherë do t'i ndalojë negociatat në lidhje me një "marrëveshje tregtare 100 miliardë dollarësh" me Turqinë. "Shtetet e Bashkuara dhe partnerët tanë kanë mposhtur 100 për qind të kalifatit të pamëshirshëm territorial të ISIS-it. Turqia nuk duhet t'i vë në rrezik këto arritje", thuhet në deklaratë.

Nënpresidenti amerikan Pence paralajmëroi se sanksionet "do të vazhdojnë dhe do të ashpërsohen, përveç nëse Turqia e vendos një armëpushim të menjëhershëm, ndalon dhunën dhe pranon të negociojë një zgjidhje afatgjatë të çështjeve përgjatë kufirit midis Turqisë dhe Sirisë".

Nënpresidenti përsëriti gjithashtu se ShBA-ja "nuk i dha dritën jeshile Turqisë për të pushtuar Sirinë".

Më herët, më 14 tetor, disa vende të Bashkimit Evropian u angazhuan t'i pezullonin eksportet e armëve në Turqi. Si përgjigje, Turqia tha se do të shqyrtojë bashkëpunimin e saj me BE-së për shkak të qëndrimit të saj "të paligjshëm dhe të njëanshëm".

## Putin shkon në Emiratet e Bashkuara Arabe, diskuton për investime

**Moskë, 15 tetor** - Presidenti rus, Vladimir Putin, ka arritur në Emiratet e Bashkuara Arabe, duke shënuar vizitën e tij të parë në këtë shtet të Gjirit Arab në më shumë se një dekadë. Putini ka udhëtuar më 15 tetor nga Arabia Saudite për t'u takuar me princin e kurorës së Abu Dabit, Muhammad bin Zayed Al Nahyan. Në Riad Putini është takuar me mbretin dhe princin e Arabisë Saudite, teksa Moska synon ta rrisë praninë e vet në Lindje të Mesme.

Putini dhe Mbreti Salman kanë nënshkruar marrëveshje në vlerë të miliarda dollarëve për investime në mes të të dy shteteve, duke shënjestruar sektorin e kulturës, shëndetësisë dhe teknologjisë së avancuar.

Në marrëveshje është arritur pajtueshmëri për ta "riforcuar" bashkëpunimin në mes të organizatës 24-anëtarëshe të vendeve eksportuese të naftës (OPEC) dhe 10 vendeve të tjera që nuk janë anëtare të saj, ka thënë ministri saudit i Energjisë, Abdulaziz bin Salman.

Rusia nuk është anëtare të OPEC-ut, mirëpo ka punuar ngushtë me këtë grup me qëllim të rritjes së çmimeve të naftës, pas rënies së çmimeve që ka ndodhur më 2014 dhe për rezultat ka dëmtuar rëndë ekonominë ruse.

Vizita e parë e Putinit në shtetin e pasur me naftë prej vitit 2007 ka ndodhur pasi Moska ka dështuar ta përmbushë synimin për rritje të bruto prodhimit të brendshëm për 3 për qind si dhe vazhdon të përballet me sanksione nga vendet perëndimore.

Kjo vizitë, po ashtu, është realizuar në kohën kur janë rritur tensionet në Gjirin Persik për shkak të disa sulmeve në rafineritë saudite të naftës muaj më parë.

Shtetet e Bashkuara, Arabia Saudite dhe një numër i vendeve perëndimore kanë fajësuar Iranin për këto sulme, po ky i fundit mohon çdo përfshirje.




Shijo Pranverën me...
Jaffa Champion PLUS
A+C+E
Multifrutti
Taste of World Wide Brand!
2L
Jaffa Champion


AUTOSHKOLLA
"RITMO – L"
Auto Shkolla
"RITMO - L"
Prishtinë
Eksperienca jonë - përfitimi i juaj.
Ju mirëpret:
Stafi i Auto Shkollës " Ritmo -L "
Tel / kontakt:
044 248 173
044 200 604
044 375 333

E rrallë

## Shtëpia më e hollë në botë quhet "Nga inati"



Beiruti, kryeqyteti i Libanit, është një nga vendet që po e vuan mungesën e tokave dhe rritjen e popullsisë, por kjo ndërtesë ka një arsye tjetër që ka atë formë. Kjo shtëpi është katër metra te pika më e gjerë dhe më pak se një metër te pika më e ngushtë e saj. Shtëpia quhet "Nga inati" dhe njihet nga banorët prej shtatë dekadash. Ndërtesa u ngrit në vitet 1950 si pasojë e një sherri mes dy vëllezërve. Ata nuk u morën dot vesh se si do ta ndanin tokën e trashëguar dhe, veç kësaj, ndërtimet e bashkisë ia zvogëluan pronën edhe më shumë.

FOTO E DITES




Shirat e mëdha në Japoninë qendrore kanë bërë që linja hekurudhore të përfshihet nga uji.

E jashtëzakonshme

## Djali tetëvjeçar kap peshkaqenin 314 kilogramë



Një tetëvjeçar kapi një peshkaqen tigër 314 kilogramë gjatë një udhëtimi peshkimi me babanë e vet në Australi. Raportohet se ka vendosur një rekord të ri botëror. Jonathan Millauro dhe djali i tij Jayden gjetën peshkaqenin javën e kaluar në det rreth 160 kilometra (100 milje) në jug të Sidneit. Pasi peshkaqeni arriti afër varkës së tyre, Jayden, i cili peshon vetëm 40 kilogramë, arriti ta kapë me spango peshkimi, ndërsa një prej burrave të tjerë mbante parzmoren. Djali mësoi si të peshkonte në moshën tetëmbëdhjetëmuajshe.

### BARSOLETA E DITËS



**- Qysh bre s'të vjen marre t'i ndihmosh gruas me përgatit bukën?**
**- Asgjë të keqe nuk ka këtu!**
**- Qenke lig shumë.**
**- Edhe ajo po më ndihmon t'i laj enët!**

KINO ABC PRISHTINE

### Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

**Çdo ditë në ora 16:00**

## Toy Story 4 / 3D

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 40 min

**Rolet:** Tom Hanks (Woody), Annie Potts (Bo Peep), Tim Allen (Buzz Lightyear), Tony Hale (Forky), Keegan-Michael Key (Ducky), Madeleine McGraw (Bonnie), Christina Hendricks (Gabby Gabby), Don Rickles (Mr. Potato Head), Jordan Peele (Bunny), Wallace Shawn (Rex), John Ratzenberger (Hamm), Keanu Reeves (Duke Caboom), etj.

**Regjia:** Josh Cooley







**Në ora 18:00 dhe 20:00**

## AD ASTRA

Aventurë/Dramë/Mister; 2 orë 04 min

**Rolet:** Brad Pitt, Tommy Lee Jones, Ruth Negga, Liv Tyler, and Donald Sutherland

Regjia: James Gray

**Çdo ditë në ora 22:00**

## DOWNTON ABBEY

Dramë; 2 orë 02 min

**Rolet:** Hugh Bonneville, Jim Carter, Michelle Dockery, Elizabeth McGovern, Maggie Smith, Imelda Staunton, Penelope Wilton, etj.

**Regjia:** Michael Engler




**Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**



**DASHI**
Meditimi dhe joga duhet të praktikohen për përfitime shpirtërore dhe fizike.



**DEMI**
Emocionet e forta dhe shpërthyese mund t'ju dëmtojnë.



**BINJAKËT**
Forca juaj e brendshme do t'ju mbështesë për ta bërë ditën e mrekullueshme në punë.



**GAFORRJA**
Një punë e rëndësishme do të ndalet për shkak të pozicionit të zymtë financiar.



**LUANI**
Inkurajoni mendjen veten që të jeni të hapur ndaj emocioneve pozitive sikurse dashuria.



**VIRGJËRESHA**
Dikush me të cilin jetoni do të mërzitet nëse keni shpërfillur detyrat tuaja shtëpiake.



**PESHORJA**
Mbani nën kontroll peshën dhe mos e teproni me ushqimet.



**AKREPI**
Stili i jetesës suaj ekstravagante mund të shkaktojë tensione në familje, por do të jeni në sinkronizim me 'rrahjet e zemrës' së partnerit tuaj.



**SHIGJETARI**
Përmirësimi i shëndetit duhet të jetë një çështje dite.



**BRICJAPI**
Jini optimist dhe shikoni anën e ndritshme.



**UJORI**
Bëni kujdes me shëndetin, pasi rezistenca juaj do të jetë e dobët.



**PESHQIT**
Sjellja juaj e vrazhdë do të shkaktojë zhgënjim te të tjerët.



# David Harbour dhe Lily Allen puthen plot pasion në Nju Jork

David Harbour dhe Lily Allen duket se nuk mund të rrinë larg njëri-tjetrit ose të paktën ata kanë lënë këtë përshtypje derisa janë parë gjatë ditës së diel në qytetin e Nju Jorkut. Ylli 44-vjeçar i "Stranger Things" dhe 34-vjeçarja Allen janë fotografuar duke u puthur plot pasion rrugëve të Nju Jorkut dhe duke ia mbajtur duart njëri-tjetrit.

# Lucy Mecklenburgh, shtatzënë dhe me linja mahnitëse




Në fillim të këtij muaji ajo ndau me ngazëllim lajmin se po pret një djalë me të fejuarin Ryan Thomas. Dhe Lucy Mecklenburgh, 28 vjeçe, me dashuri shfaqi format prej shtatzëne kur u largua për të marrë pjesë në nisjen e koleksionit të Pronovias 2020 në Londër të hënën. E veshur me një fustan luksoz të kaltër, ish-ylli i Towie ndoqi ngjarjen vetëm disa orë pasi zbuloi se ajo do të jetë larg nga burri i saj për një muaj të tërë.



# Dua Lipa nis xhirimet e klipit të ri

Këngëtarja e njohur Dua Lipa ka nisur xhirimet e klipit më të ri. Lipa përmes disa imazheve të ndara në mediat rozë ka bërë me dije se aktualisht gjendet në Nju Jork City, duke realizuar filmimet e projektit të ri. Dua Lipa, e cila vjen nga Prishtina, dukej klasike dhe tejet elegante me një pallto në nuancë të ndezur të viteve të '80-ta. Paraqitjen e saj e bëri edhe më të bukur qëndrimi i saj në mënyrë artistike në një ballkon rrugëve të Brooklynit.

# Victoria Beckham, plot elegancë në aeroportin John F. Kennedy



Ajo kurrë nuk ka qenë një njëri që përzihet në sfond. Victoria Beckham u sigurua që të gjithë sytë do të ishin tek ajo derisa ajo u hodh poshtë në aeroportin John F. Kennedy të Nju Jorkut. E veshur me elegancë dhe përplasje ngjyrash, stilistja 45-vjeçare la përshtypje derisa shëtiste në terminal.



| | | | | | | Autor: GAZMEND MORINA | KËNGËTARI DHE AKTORI AMERIKAN NË FOTO (shqip.) | VIJË E PËRKULUR SI LAK, VIJË E LAKUAR | INSTITUCION I LARTË SHKENCOR | SHTET NË AZI (pashq.) | IGLI TARE | PEMË FRUTORE ME KURORË TË GJERË E TË DENDUR | SHKRIMTARI .... SHEHU | MOÇALI, LIGATINA | TERRITOR I IMAMIT (sh.shq.) | MOLDE | I RI ZATETUR |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | RENDITJA | | | | | | | | | | | |
| | | | | | | SËMUNDJE E FËMIJËVE, QË SHFAQET ME SHTREMBË-RIMIN E ESHTRAVE | | | | | | | | | | BASHKËT. / SMIRË | |
| | | | | | | FLUTURUESI I PARË SIPAS MITOLOGJISË (pashq.) | | | | | AKTORI TURK IMIRZALIOGLU (shq.) / TRAJNERI FATIH ..... (Galatasaray) | | | | | | |
| | | | | | | SHIKOJ DIÇKA PËR NJË KOHË TË GJATË; KUNDROJ | | | | | | OBJEKTI I BISEDËS (sh.shq.) / REGJISORI KRYEZIU | | | | | |
| | | | | | | BOR, RENIUM | | | | SHKRONJA TË NJËJTA / FJALË E RËNDË, E PAHIJSHME | | | THEMBRA E KËPUCËS | | | | |
| | | | | | | SHKRIMTARI GJERMAN ERIK MARIA | | | | | | | SULM, MËSYMJE / I SPËRKAT ME UJË | | | | |
| | | | | | | ZANORE | | PARAARDH-ËSI YNË / KËNGËTARJA MEKSIKANE RUBIO | | | | | | ERBIUM, URAN | | | |
| EPOKA E RE | SHKËMB SHUMË I FORTË | TMERR | I MBAROVA, I PËRFUNDOVA | NËNNDARJE E NJË LIGJI | ALUMIN | ULSION POL | | | BAR PËR TË DALË JASHTË / I DOBËT; I PAFUQI | | | | | TOTENHAM / TOROLLAKU | | ZANORE / I PISTË | |
| DELTINA E BARDHË A E KUQE, ARGJILA | | | | | | MUZIKANTI .... KRASNIQI / ILAZ KODRA | | | | | KRAHINË NË SHQIPËRI / ILUZIONISTI SHQIPTAR NADIR .... | | | | DY BASHKË-TINGËLLORE / FUTBOLLISTI DIARRA | | |
| KRYENGRI-TËSI | | | | | | | KUNDREJT NGJITEM / FEMRA LUFTËTARE QË NUK MARTOHEJ | | | | | SHËNIM NË FUTBOLL / SHKËMB I PËRBËRË PREJ RËRE TË NGJESHUR | | | | | DIÇKA E MËRZITSHME, NGAQË PËRSËRITET GJITHNJË (shq.) |
| ➛ | | | | | ÇELIKOSUR / DY BASHKË-TINGËLLORE | | | | | | | | SECILA NGA TRAJTAT E NDRYSHME QË MERR EMRI / INFERMIERE PËR FOSHNJA | | | | |
| PRIFT HEBRAIK / RRJETË E TENISIT | | | | HAITI | | LLOJ AVIONI USHTARAK / PËRFAQËSI DIPLOMATIKE (hist.) | | | | FUTBOLLISTI SPANJOLL SERGIO ..... / PIKTORI I FAMSHËM PABLO ...... | | | | | | BASHKËT. / JOD, ELEKTRON | |
| INTENSITET, TITAN | | | | SKICË / MA JEP | | | | | SHTET I VOGËL NË AMERIKË / NAIM OSMANI | | | | | | | | |
| LUMË I MADH NË HUNGARI | | | | | THIRRJA E MYEZINIT / I BËRË GATI | | | | | | BANOR I NJË SHTETI AZIATIK / MASHKULLI I PARË | | | | | | |
| EPOKA E RE | QË ËSHTË I LIRË NË MENDIME | SHOK (spanj.) / ANËTARËSIM NË NJË ORGANIZATË (shq.) | | | | | | VEGËL MUZIKORE / ZANORE | | | | | | | | INTER / MALI MË I LARTË NË TURQI | |
| NOTË MUZIKORE | | | POLITIKANI FERID ..... / PUNIM I ARËS | | | | | | AFËRDITA DRESHAJ / FAZAT | | | TINARËT | ZANORE / FRIKACAK | | ZANORE / DY BASHKË-TINGËLLORE | | SFOND SHKRONJASH |
| INSTITUTE DEFENSE ANALYSES | | | | PËREMËR VETOR / KUNDREJT E VJETËR | | | | PIKTORI .... VALLA (shq.) / TRAJNERI ITALIAN ..... SAKI | | | | | | KRIMB I DRURI | | | |
| LLOJ REVOLEJE ITALIANE | | | | | | | NUKLEAR / EMËR I VJETËR PËR VIETNAMIN | | | | | | | PËRFUNDIM NË SHAH / FUTBOLLISTI KROAT KRANJÇAR | | | |
| ARKA SHTETËRORE (lat.) | | | | | | TOKA E BUKËS | | | | PERSIA E SOTME (pashq.) / RAFINERIA E ZAGREBIT | | | | | RAMADAN AVDIU / "A" në mes të dy "M" | | |
| CEREMONITË FETARE | | | | | | DJALI I DJALIT / RODA | | | | | SHTAZOR | | | | | | |
| LLOJ VETURE FRANCEZE | | | | STUHI E FORTË ME ERË DHE SHI / ZANORE | | | | | | | FORCA, FUQIA / RAVENA | | | | | | |
| STROFULL QË BËJNË DISA KAFSHË NË PYLL TË DENDUR | | | | | | MOTAK, QË KA MBUSHUR NJË VIT, NJËVJEÇAR | | | | | | AKTOR KOMEDISH | | | | | |

# Lëngu i fuqishëm për pastrimin e gurëve në veshka dhe tëmth - si ta përgatisni

Statistikat botërore thonë se 1 në 10 njerëz në botë vuajnë nga gurët në veshka.
Sipas të dhënave të AgroWeb.org, shkaktari kryesor i këtij problemi mbetet sasia e mangët e ujit, ndjekur nga ngrënia e ushqimeve shumë të kripura ose të ëmbla.
Shkaktarë të tjerë janë mungesa e aktivitetit fizik, ndërhyrjet kirurgjikale për rënie në peshë, mbipesha dhe infeksionet.
Rreziku i formimit të gurëve në veshka është i lartë edhe falë konsumit të sheqerit.

### Si formohen gurët në veshka

Akumulimi i një numri të madh mbetjesh dhe rënia e nivelit të lëngjeve në trup, nxit formimin e kristaleve.
Këto të fundit bashkohen më masa të tjera të forta dhe krijojnë gurët në veshka.
Gurët mund të qëndrojnë në veshka ose të rrugëtojnë nëpërmjet traktit urinar.
Nëse gurët janë të mëdhenj, gjatë lëvizjes ato shkaktojnë dhimbje.
Nëse janë të vegjël, ato dalin nga organizmi pa dhimbje.
Për të parandaluar formimin e gurëve, njeriu duhet të pijë shumë ujë dhe lëngje të tjera.
Nëpërmjet këshillave të mëposhtme të AgroWeb.org do të mund të shmangni formimin e gurëve në veshka.

### Çfarë duhet të shmangni dhe çfarë duhet të konsumoni

Shmangni ushqimet me shumë kalçium
Shmangni ushqimet me shumë kripë
Konsumoni më pak ushqime me proteinë shtazore
Mos konsumoni sojë, lajthi, shqeme, kikirikë, bajame, çaj të zi dhe spinaq
Konsumoni limon. Limoni përmban acid citric që shkrin kristalet e kalçiumit
Shalqini është i mirë sepse stimulon heqjen e gurëve në veshka.
Kaliumi shkrin gurët në veshka.
Pini një gotë me ujë përpara se të flini dhe kur të zgjoheni.
Lëngu i mëposhtëm sipas udhëzimeve të AgroWeb.org, do ju vijë në ndihmë në trajtimin natyral të gurëve në veshka.
Ky lëng është i rekomandueshëm edhe për gurët në tëmth.



### Receta e lëngut kundër gurëve në veshka dhe tëmth përbërësit:

4 thela shalqini pa lëkurën
1 limon i qëruar
1 portokall i qëruar
1 mollë
4 kuba akulli ose pak ujë sipas dëshirës
Mund t'i shtoni gjethe majdanozi nëse dëshironi

### Përgatitja:

Përziejini të gjithë përbërësit në një mikser dhe pijeni menjëherë.
Efektet e kësaj pijeje janë të shpejtë dhe domethënëse.
Këtë lëng mund ta pini çdo ditë për rreth 20 ditë dhe ta përsërisni për disa muaj deri sa të vini re përmirësime.

**AgroWeb.org**

** Ky informacion ka për qëllim të plotësojë, të mos zëvendësojë këshilla nga mjeku juaj ose ofruesi i kujdesit shëndetësor dhe nuk ka për qëllim të mbulojë të gjitha përdorimet e mundshme, masat paraprake, ndërveprimet ose efektet negative. Ky informacion mund të mos i përshtatet rrethanave tuaja specifike shëndetësore.*
Burimi: U.S. National Library of Medicine

# Kura 30 ditore me piper të zi dhe qumësht për tiroiden



Çrregullimet e gjëndrës së tiroides lidhen me mos balancimin e duhur të proceseve të metabolizmit në organizmin tonë.
Këto probleme ndikojnë ose në strukturën e tiroides ose në funksionimin e duhur të saj.
Gjëndra e tiroides luan rol kryesor në prodhimin e tiroksinës.
Një hormon shumë i rëndësishëm për tretjen, funksionimin e muskujve dhe të zemrës si dhe për zhvillimin e qelizave të trurit dhe kockave.
Veprimtaria e tiroides rregullohet përmes një mekanizmi që përfshin dhe trurin.
Kur hormoni i tiroides është në një nivel të ulët, hipotalamusi që ndodhet në tru lëshon një sinjal që nxit çlirimin e tiroksinës në gjak.
Sipas të dhënave ku bazohet dhe AgroWeb.org, është vënë re një rritje e përqindjes së popullsisë së prekur nga ky çrregullim.

### Duke qenë se funksionimi i tiroides varet nga shumë faktorë të tjerë të organizmit, dhe trajtimi i saj është shumë delikat.

Një nga metodat natyrale për trajtimin e saj, është dhe kura me qumësht, piper të zi dhe xhinxher.
Piperi i zi njihet për përmbajtjen e magnezit, hekurit dhe vitaminës K që ndihmojnë në qarkullimin dhe rigjenerimin e qelizave të gjakut.
Nga ana tjetër xhinxheri është i famshëm për agjentët antiinformator që luftojnë prekjen e organizmit nga baktere të dëmshme.
Kjo kurë trajton rastet e hipotiroides (funksioni i ulët i gjëndrës së tiroides, gjendje që karakterizohet me prodhim të ulët të hormoneve nga kjo gjendër).
Hipotiroidja ka si simptoma lodhjen kronike, depresionin, stresin, kollë të mjaftueshme.
Kjo sëmundje zbulohet përmes analizave të gjakut dhe tiroides.

### Përbërësit:

100 g piper i zi kokërr
100 g xhinxher i tharë
Qumësht

### Përgatitja:

Në një grirëse vendosim piperin dhe xhinxherin dhe i lëmë të bluhen.
Në momentin që është formuar një pluhur homogjen, përbërja është gati.
Mjafton që një lugë çaji nga ky pluhur ta përzieni në një gotë qumësht dhe përbërja natyrale është gati.
Kura duhet të konsumohet dy herë në ditë, një herë para se të flini dhe njëherë në mëngjes me stomakun bosh.
Në mënyrë që të shikoni rezultate në balancimin e funksionimit të tiroides, duhet që këtë kurë ta vazhdoni për 30 ditë dhe ta përsërisni edhe për 30 ditë të tjera.
AgroWeb.org ju këshillon që nëse doni të përgatisni më shumë nga ky pluhur, mjafton vetëm që masat e piperit të zi dhe xhinxherit të jenë të barabarta./**AgroWeb**

** Ky informacion ka për qëllim të plotësojë, të mos zëvendësojë këshilla nga mjeku juaj ose ofruesi i kujdesit shëndetësor dhe nuk ka për qëllim të mbulojë të gjitha përdorimet e mundshme, masat paraprake, ndërveprimet ose efektet negative. Ky informacion mund të mos i përshtatet rrethanave tuaja specifike shëndetësore.*




# Sport

QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

# Llumnica: Kosova ishte superiore ndaj Malit të Zi

"Në ndeshjen kundër Malit të Zi, Kosova ishte fantastike dhe paraqitja e saj ishte në vazhdën e paraqitjeve të mira që po bën në këto eliminatore", kështu e vlerësoi Ardian Llumnica paraqitjen e Kosovës ndaj Malit të Zi, e cila përfundoi me rezultat 2-0. Analisti dhe trajneri i futbollit pikën më të dobët të "Dardanëve" në ndeshjen ndaj malazezëve e cilësoi moskonkretizimin e rasteve të shumta për shënim



EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 15 TETOR - Analisti i futbollit në Kosovë, Ardian Llumnica, e ka lavdëruar përfaqësuesen e Kosovës për paraqitjen e bërë në ndeshjen kualifikuese ndaj Malit të Zi, të cilën "Dardanët" e fituan me rezultat 2-0. Ai ka thënë të martën për "Epokën e re" se Kosova dominoi në të gjitha ndaj kundërshtarit në stadiumin "Fadil Vokrri", kurse e vetmja dobësi nga futbollistët e drejtuar nga trajneri Bernard Challandes ishte moskonkretizimi i rasteve të shumta që kishin. "Në ndeshjen kundër Malit të Zi, Kosova ishte fantastike dhe paraqitja e saj ishte në vazhdën e paraqitjeve të mira që po bën në këto eliminatore. Ne dominuam në të gjitha aspektet ndaj malazezëve. Brenda këtij dominimi ndaj malazezëve ka diçka që shkoi shumë mirë dhe diçka që duhet përmirësuar, pra duhet të jemi më konkretë", ka thënë Llumnica.

Trajneri i futbollit, Ardian Llumnica, i lavdëroi lojtarët e mesfushës për atë që treguan, por ka thënë se gabimet në mosshënimin e golave në rastet e krijuara duhet të ndryshojnë në dy ndeshjet e radhës ndaj Çekisë dhe Anglisë për faktin se ato janë skuadra më të forta dhe është e vështirë të krijohen shumë shanse shënimi. "Mesfusha e Kosovës ishte shumë kreative si me posedim, driblim dhe me pasime të sakta. Vlen të theksohet që kishim problem me konkretizim apo finalizim para portës, sidomos në pjesën e dytë. Këtë gjë selektori ynë duhet ta korrigjojë sepse në ndeshjen e radhës kundër Çekisë dhe Anglisë është vështirë të krijohen aq shumë raste ideale për shënim sikurse ndaj Malit të Zi dhe kështu çdo rast të vetëm duhet ta konkretizojmë me gol, madje të jemi vigjilentë edhe në gjysmëraste për shënim", ka shtuar Llumnica.

Skuadra përfaqësuese e Kosovës dy ndeshjet në kualifikimet për "Euro 2020" i zhvillon në muajin nëntor. Fillimisht i shkon Çekisë e më pas e pret Anglinë në stadiumin "Fadil Vokrri". Llumnica ndeshjen ndaj çekëve e ka vlerësuar më të rëndësishmen deri tash për Kosovën, kurse Çekinë e ka cilësuar kombëtare të fortë, por që nuk është e pamposhtur edhe kur luan në shtëpi të vet. "Nuk do mend se ndeshja me Çekinë është më e rëndësishmja e Kosovës deri më tani, madje edhe për çekët është ndeshje kyçe për një biletë në evropian. Ata kanë një kombëtare të mirë në të gjitha aspektet dhe vetë fakti që e mposhti Anglinë tregon për forcën e tyre, por kjo nuk do të thotë se janë të pamposhtur. Tashmë edhe Kosova edhe Çekia janë të njohura me specifikat e kombëtareve dhe kështu forma apo dita e disa futbollistëve si dhe disiplina taktike si grup do të përcaktojnë apo do të jenë faktorë kyçe për fituesin eventual", ka përfunduar Llumnica.

Kosova pas gjashtë ndeshjeve renditet në pozitën e tretë me 11 pikë, kurse Çekia ka një pikë më shumë dhe renditet në pozitën e dytë.

## Prokuroria fillon hetimet për shitjen e biletave

Shitja e biletave për ndeshjet e Përfaqësueses së Kosovës në vazhdimësi është përcjell me probleme, edhe pse Federata e Futbollit të Kosovës është përpjekur që këtë problem të shmangë me shitjen e tyre në mënyrë online. Biletat për ndeshjen e fundit në mes të Kosovës dhe Malit të Zi janë shitur nëpërmjet aplikacionit "tiks.app", por kanë mjaftuar vetëm shtatë minuta që të shiten të gjitha biletat dhe kjo ka ndikuar që të rriten dyshimet për keqpërdorim. Prokuroria e Shtetit ka filluar hetimet për mënyrën e shitjes së biletave.

# Mabetex Prishtina sot debuton në FIBA 'Eurocup Women'

PRISHTINË, 15 TETOR - Kampionia e Kosovës në basketboll në konkurrencën e femrave, KBF Mabetex Prishtina, sot (e mërkurë) do të debutojë në garat e FIBA 'EuroCup Women'. Kjo është hera e parë që një klub nga Kosova merr pjesë në një garë të nivelit të tillë. Vashat prishtinase ndodhen në një grup me dy skuadrat ruse, Sparta &K Moskow Region Vidnoje, MBA Mosow dhe Beshiktashin e Turqisë. Ndeshja e parë për vashat kryeqytetase do të jetë më 16 tetor në udhëtim te



MBA Mosow, derisa ndeshjen e parë në shtëpi do ta kenë ndaj Spartas, më 24 tetor. Më 31 tetor e presin Beshiktashin, si dhe më pas e presin MBA Moscow më 7 nëntor. Dy ndeshjet e fundit do të jenë si mysafirë, ndaj Spartës më 27 nëntor dhe 5 dhjetor ndaj Beshiktashit. Dy ekipet e para kualifikohen tutje.

Trajneri i Mabetex Prishtinës, Fidan Shatri, është shprehur se e rëndësishme është që të kenë paraqitje sa më të mirë. "Do të mundohemi të kemi një paraqitje sa më të mirë në garat evropiane. Kjo është paraqitja e parë në këto gara dhe nuk kemi përvojë. Jemi në një grup shumë të vështirë, megjithatë ne synojmë të bëjmë paraqitje të mira dhe ta përfaqësojmë basketbollin e Kosovës sa më mirë, pasi dihet forca e skuadrave kundërshtare", është shprehur Shatri për faqen zyrtare të FBK-së.

MBA Mosow-Mabetex Prishtina zhvillohet të mërkurën nga ora 18:00. Kjo është hera e parë që një klub kosovar merr pjesë në gara ndërkombëtare, që pas sezonit 2003/2004 kur Universiteti i Prishtinës ka garuar në Ligën Rajonale Trocal.

## Sot takohen Prishtina - Drenica

PRISHTINË, 13 TETOR - Pas ndeshjeve të përfaqësueses së Kosovës në futboll, rikthehet IPKO Superliga e Kosovës. Ndeshja e vetme që zhvillohet sot (e mërkurë) është ajo në mes të skuadrës së Prishtinës dhe Drenicës nga Skenderaj. Kjo është ndeshja e mbetur e javës së tetë, kurse zhvillohet nga ora 18:00 në stadiumin "Fadil Vokrri". "Prishtina pas humbjes me Ballkanin do të provojë të këndellet me fitore kundrejt kuqezinjve nga Skenderaj", thuhet në njoftimin e klubit kryeqytetas. Prishtina është e gjashta në tabelë me 13 pikë, kurse Drenica është e teta me 9 pikë.



## Përfundoi sezoni për Sharapovan



MOSKË, 15 TETOR - Tenistja ruse Maria Sharapova e ka mbyllur para kohe sezonin 2019. Ish-numri një në botë ka bërë me dije se nuk do të luajë më në asnjë turne në pjesën e mbetur të këtij sezoni. Bukuroshja ruse ka vendosur të tërhiqet për të pasur më shumë kohë për t'u rikuperuar nga dëmtimi në shpatull dhe të rikthehet në formë në janar të 2020-s. Sharapova u tërhoq javën e kaluar nga turneu i Linzit (Austri) dhe para pak orësh konfirmoi se nuk do të garojë as në turneun e Luksemburgut. Pas këtyre dy tërheqjeve Sharapova deklaroi se nuk do të luajë më këtë sezon. Ndeshja e saj e fundit është ajo e US Openit, kur u mund që në raundin e parë nga Serena Williamsi.

# Reja: Po të fitonim në Turqi do të ishim në evropian



TIRANË, 15 TETOR - Shqipëria siguroi një fitore të madhe përballë Moldavisë, një fitore historike me "poker" golash që nuk kishte ndodhur kurrë më parë në një transfertë. Kuqezinjtë zhvilluan një ndeshje të përkryer. Meritë për këtë sukses ka edhe Edy Reja. Në një video të bërë publike nga Federata Shqiptare e Futbollit, tekniku italian ka pagëzuar lojtarët për gjithçka që dhanë në fushë, jo vetëm në këtë sfidë, por në të gjithë këtë rrugëtim që kanë nisur së bashku. Por, pengu më i madh mbetet ajo humbje në Turqi. "Pavarësisht se tifozët jua thërrasin emrin, jeni ju ata që keni arritur të ndërtoni këtë grup kaq të mirë. Si ju këtu edhe stafi që punon mbas trajnerit. Ju përgëzoj dhe ju falënderoj të gjithëve. Merita është vetëm e juaja. Unë kam 35 vjet që e bëj këtë punë. Nuk kam nevojë të marr merita apo të më lavdërojë dikush. Merita është gjithmonë e juaja sepse keni bërë një punë të shkëlqyer. Nëse do të kishim fituar ndaj Turqisë do të shkonim në Evropë. Duhet të kishim 4 pikë më shumë. 3 me Turqinë dhe 1 me Islandën. I kemi bërë të gjitha ndeshjet mjaft të mira, Turqisë i treguam se kush jemi, ndërsa Franca është Francë, nuk ka vend për diskutim. Kemi zemër", ka thënë Reja.

# Pas thirrjeve raciste ndaj Anglisë, jep dorëheqje Mikhailovi



SOFJE, 15 TETOR - Kryetari i Federatës së Futbollit i Bullgarisë, Borislav Mikhailov, ka dhënë dorëheqje nga posti i tij ashtu siç iu kërkua nga kryeministri i Bullgarisë, pas thirrjeve raciste nga tifozët bullgarë drejt futbollistëve me ngjyrë të Anglisë gjatë ndeshjes që është zhvilluar të hënën në Sofje në kuadër të "Euro 2020". Përballja mes Bullgarisë dhe Anglisë u ndal në dy raste gjatë pjesës së parë, pasi që tifozët vendës në tribuna po i ofendonin futbollistët me ngjyrë të Anglisë me thirrje raciste.

Protokolli i ri i UEFA-s thekson se gjyqtarët e kanë autoritetin për ta suspenduar ndeshjen dhe në fund mund të vendosin ta braktisin plotësisht ndeshjen në rrethana të tilla. Dy hapat e parë të një plani trehapësh u implementuan në kryeqytetin bullgar, pasi tifozëve fillimisht iu kërkua ndalja e thirrjeve raciste, pastaj ndeshja u pezullua sërish për pak kohë. Në fund u mor vendimi për të mos e braktisur ndeshjen, që përfundoi me rezultat 6-0 për anglezët, mirëpo një numër i tifozëve bullgarë u larguan nga stadiumi me forcë nga rojet e sigurimit. Megjithatë, tani pritet që Bullgaria të përballet me një dënim nga UEFA për incidentet e ndeshjes, për të cilat Federata e Futbollit e Bullgarisë nuk ka bërë shumë t'i parandalojë. Tani është bërë me dije se presidenti i Federatës së Futbollit të Bullgarisë e ka përmbushur kërkesën e kryeministrit të vendit për dorëheqje dhe së shpejti do të bëhet i ditur edhe zëvendësuesi i tij.

## SHKURT

### Hamiltoni: Ferrari ka motor të fuqishëm, por ata nuk dinë të fitojnë

Edhe pse Ferrari ishte më i shpejtë në provat zyrtare në pistën Suzuka nuk arriti të fitojë. "Kokëkuqja" i klasifikoi të dy pilotët e vet në vijën e parë të startit, por në fund triumfoi Valtteri Bottasi me Mercedes. Ndërsa shoku i tij i skuadrës, Lewis Hamiltoni, doli i treti. "Motori i Ferrarit po bën diferencën muajt e fundit, duke qenë më i fuqishëm dhe i shpejtë. Edhe pse e mbaj të shtypur pedalen e gazit deri në fund, nuk arrijmë t'i kapim", u shpreh Hamiltoni në një intervistë për "RTL". "Për fat të mirë, gara është një tjetër gjë. Në Suzuka fituam edhe për shkak të gabimeve që bëjnë te Ferrari, që nuk dinë të përfitojnë nga avantazhi i motorit. Ne po punojmë për të kuptuar se ku mund të përmirësohemi për të qenë më të shpejtë", ka shtuar Hamiltoni.

### Marchisio: Për Juven i refuzova Unitedin, Cityn dhe Chelsean

Claudio Marchisio ka zbuluar se ishte kërkuar me ngulm nga klubet angleze vite më parë. Ish-mesfushori i Juventusit ka thënë se Manchester Unitedi, Manchester City dhe Chelsea kishin tentuar disa herë transferimin e tij. Por, legjenda e "Zonjës së Vjetër" ka deklaruar se ai nuk e kishte menduar asnjëherë largimin nga kampioni i Serisë A-së dhe nuk i kishte konsideruar asnjëherë ofertat e klubeve angleze. "Nuk mund të them se isha afër kalimit në Ligën Premiere, por interesim të madh kishte. Manchester Unitedi, Manchester City dhe Chelsea kishin bërë disa tentime për të më transferuar, por nuk kam zhvilluar bisedime me asnjërën prej tyre. Ju ndoshta pyesni se përse. Është shumë e thjeshtë. Juventusi gjithmonë ka qenë prioriteti im, kështu që nuk kisha arsye se përse t'i filloja bisedimet me to", ka thënë Marchisio.

### Simone Biles, gjimnastja më e madhe e të gjitha kohëve

Simone Biles ka shënuar një tjetër rekord, duke hyrë në historinë e gjimnastikës artistike. Sportistja amerikane, në moshën 22-vjeçare, me dy sukseset e fundit në ushtrimet dhe tra dhe ushtrimet e lira në Botërorin e Shtutgartit, e ka çuar në 19 numrin e medaljeve të arta në karrierë, ndërsa në total numëron 25 medalje, duke thyer kështu rekordin e bjellorusit Vitaly Scherbo, që mes viteve 1991 dhe 1996 kishte koleksionuar 23 medalje në karrierë. Në ushtrimet mbi tra Simone Biles mposhti konkurrencën e dy garueseve kineze, Liu Tingting e Li Shijia, ndërsa në ushtrimet e lira la pas bashkëkombësen e vet, Sunisa Lee dhe rusen Angelina Melnikova. Karriera e saj është për rekord: Biles është e vetmja gjimnaste që ka fituar pesë tituj botërorë (Anversa 2013, Nanning 2014, Glasgow 2015, Doha 2018 e Shtutgart 2019). Në Olimpiadën e fundit të zhvilluar në Rio de Janeiro (2016) ka fituar katër medalje të arta dhe një të bronztë.

### Ronaldo e dëshiron Iscon te Juve

Cristiano Ronaldo raportohet të ketë kërkuar Iscon në Juventus. Mesfushori është përfolur për një transferim te "Zonja e Vjetër" dhe ndërsa bisedimet u zhvilluan edhe në janarin e kaluar, në drejtim të lojtarit nuk arriti kurrë një ofertë konkrete. Tashmë Isco vijon të mos jetë zgjedhja e parë te madrilenët nga trajneri Zinedine Zidane i cili e ka mbajtur vazhdimisht jashtë formacionit. Në këto kushte, e sidomos me misionin për të mos humbur Evropianin me Spanjën, Isco mund të vendosë të largohet së shpejti. Sipas "Don Balon", Ronaldo ka folur personalisht me Iscon dhe pret që Juventusi ta gjejë mënyrën që t'i bashkojë në Torino gjatë merkatos së janarit.

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
*Qeveria - Vlada - Government*
*Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit*
*Ministarstvo Infrastrukture i Transporta*
*Ministry of Infrastucture and Transportation*

Në mbështetje të nenit 24 të Udhëzimit Administrativ (MI) Nr. 09/2015 për Kyçje Instalime nëpër Tokën Rrugore dhe për Shfrytëzim të Tokës së Rrugëve Nacionale dhe Rajonale, paragrafit 1.4 të nenit 3 dhe paragrafit 1.5 të nenit 4 të Udhëzimit Administrativ Nr.01/2014 Mbi Caktimin e Tarifave për Shfrytëzimin e Tokës së Rrugëve Nacionale dhe Rajonale, bënë:

## SHPALLJE PUBLIKE
### për dhënien e tokës me qira

Toka e evidentuar pjesë e ngastrës nr. P-71813006-00784-0 me sipërfaqe të përgjithshme prej 2815m², pjesa e ngastrës nr. P-71813006-00785-0 me sipërfaqe të përgjithshme prej 2749m², pjesa e ngastrës nr. P-71813006-00796-06 me sipërfaqe të përgjithshme prej 1332m²,pjesa e ngastrës nr.P-71813006-00786-0 me sipërfaqe të përgjithshme prej 4683m², pjesa e ngastrës nr.P-71813006-00794-0, me sipërfaqe të përgjithshme prej 988m², pjesa e ngastrës nr.P-71813006-00791-1, me sipërfaqe të përgjithshme prej 2181m², pjesa e ngastrës nr.P-71813006-00789-0, me sipërfaqe të përgjithshme prej 2267m², pjesa e ngastrës nr.P-71813006-00788-0, me sipërfaqe të përgjithshme prej 3411m², pjesa e ngastrës nr.P-71813006-00787-0, me sipërfaqe të përgjithshme prej 3490m², pjesa e ngastrës nr. P-71813006-00775-1, me sipërfaqe të përgjithshme prej 72m², pjesa e ngastrës nr. P-71813006-00774-0, me sipërfaqe të përgjithshme prej 1009m², pjesa e ngastrës nr. P-71813006-00773-0, me sipërfaqe të përgjithshme prej 4338m², pjesa e ngastrës nr. P-71813006-00772-1, me sipërfaqe të përgjithshme prej 3535m², pjesa e ngastrës nr. P-71813006-00772-2, me sipërfaqe të përgjithshme prej 7342m², pjesa e ngastrës nr. P-71813006-771-3, me sipërfaqe të përgjithshme prej 1274m², pjesa e ngastrës nr. P-71813006-771-2, me sipërfaqe të përgjithshme prej 1469m², pjesa e ngastrës nr. P-71813006-00771-1, me sipërfaqe të përgjithshme prej 1223m², pjesa e ngastrës nr. P-71813006-10, me sipërfaqe të përgjithshme prej 106m², pjesa e ngastrës nr. P-71813006-00783-0, me sipërfaqe të përgjithshme prej 276m², Zona Kadastrale Vlashnje, Komuna e Prizrenit, te cilat pas shpronësimit sipas vendimit përfundimtar nr.09/128 datë.11. 06. 2010 dhe vendimit nr.06/12 datë 27.04.2011 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, pjesët e ngastrave kadastrale, pronë e Qeverisë së Republikës së Kosovës - Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit më seli në Prishtinë, jepen me qira vetëm për qëllime komerciale. Si dhe pjesa e ngastrës nr. P-71813023-00173-1, me sipërfaqe të përgjithshme prej 5471m², pjesa e ngastrës nr. P-71813023-00177-2, me sipërfaqe të përgjithshme prej 9399m², pjesa e ngastrës nr. P-71813023-00177-1, me sipërfaqe të përgjithshme prej 7964m²,pjesa e ngastrës nr. P-71813023-00178-2, me sipërfaqe të përgjithshme prej 3224m², pjesa e ngastrës nr. P-71813023-00181-1, me sipërfaqe të përgjithshme prej 5471m², pjesa e ngastrës nr. P-71813023-00179-0, me sipërfaqe të përgjithshme prej 6493m²,pjesa e ngastrës nr. P-71813023-00180-0, me sipërfaqe të përgjithshme prej 2676m², pjesa e ngastrës nr. P-71818023-00181-1, me sipërfaqe të përgjithshme prej 2126m², pjesa e ngastrës nr. P-71813023-00181-01, me sipërfaqe të përgjithshme prej 263m², pjesa e ngastrës nr. P-71813023-00171-2, me sipërfaqe të përgjithshme prej 4144m², pjesa e ngastrës nr. P-71813023-00171-4, me sipërfaqe të përgjithshme prej 1604m², pjesa e ngastrës nr. P-71813023-00171-1, me sipërfaqe të përgjithshme prej 7246m², Zona Kadastrale Dushanovë, Komuna e Prizrenit, te cilat pas shpronësimit, sipas vendimit përfundimtar nr. 09/128 datë, 11. 06. 2010 dhe vendimit nr. 06/12 datë 27. 04.2011 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, pjesët e ngastrave kadastrale, pronë e Qeverisë së Republikës së Kosovës - Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit më seli në Prishtinë, jepen me qira vetëm për qëllime komerciale.

### Dokumentacioni i nevojshëm:

- Certifikatën e regjistrimit të biznesit;
- Informatën për regjistrin e biznesit;
- Certifikata e TVSH;
- Certifikata e Numrit Fiskal;
- Planin ekonomik të investimeve me një përshkrim të përgjithshëm për veprimtarinë afariste në tokën të marrë me qira, në të cilat specifikohen aktivitetet afariste, si dhe ndikimi i veprimtarisë në shtimin e numrit te të punësuarave;
- Afatin e përdorimit të tokës për qiramarrje, në varësi të aktiviteteve afariste;
- Vërtetimin se nuk ka detyrime financiare ose ligjore të pashlyera ndaj shtetit;
- Nivelin e çmimit që ofron për marrjen me qiratë tokës;
- Çmimi fillestar vjetor 0,30 cent për m²;
- Garancinë bankar për sigurimin e ofertës në vlerën e qirasë.

### Kriteret:

- Të drejtë aplikimi kanë personat fizik dhe juridik, vendor dhe të huaj;
- Koha e shfrytëzimit të dhënies së tokës me qira është njëzet (20) vite, me mundësi vazhdimi;

**Data e shpalljes:** 15.10.2019
**Data e mbylljes:** 14.11.2019

### Dokumentacioni:

- Kërkesa në formë të shkruar e plotësuar dhe nënshkruar nga ofertuesit, si dhe e protokolluar në Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit;
- Letërnjoftimi;
- Kartela e bankës.

Dokumentet duhet të jenë të fotokopjuara, sepse ato nuk kthehen.

**Procedurat e aplikimit:** Kërkesat për aplikim për marrjen e tokës me qira dorëzohen në arkivin Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit, Sheshi "Nëna Terezë", ish-ndërtesa e Gërmisë - Prishtinë.

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
*Qeveria - Vlada - Government*
*Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit*
*Ministarstvo Infrastrukture i Transporta*
*Ministry of Infrastucture and Transportation*

Na osnovu člana 24. Administrativnog uputstva (MI) br. 09/2015 za priključne instalacije na putnom zemljištu i za korišćenje zemljišta nacionalnih i regionalnih puteva, stava 1.4 člana 3. i stav 1.5 člana 4. Administrativne Uredbe br. 01/2014 o utvrđivanju Tarifa za Korišćenje Zemljišta Nacionalnim i Regionalnih puteva, uradite:

## JAVNI OGLAS
### za davanje pod zakup zemljišta

Zemljište je deo parcele br. P-71813006-00784-0 ukupne površine 2815m², deo parcele br. P-71813006-00785-0 u ukupnoj površini 2749m², deo parcele br.P-71813006-00796 -06 na ukupnoj površini od 1332m², deo parcele br.P-71813006-00786-0 na ukupnoj površini 4683m², deo parcele br. P-71813006-00794-0, na ukupnoj površini 988m², deo parcele br. P-71813006-00791-1, ukupne površine 2181m², deo parcele br. P-71813006-00789-0, ukupne površine 2267m², deo parcele br.P-71813006-00788-0 , na ukupnoj površini od 3411m², deo parcele br. P-71813006-00787-0, na ukupnoj površini 3490m², deo parcele br. P-71813006-00775-1, na ukupnoj površini 72m², deo parcele br. P-71813006-00774-0, na ukupnoj površini 1009m², deo parcele br. P-71813006-00773-0, na ukupnoj površini 4338m², deo parcele br. P-71813006-00772-1, na površini od 3535m², deo parcele br. P-71813006-00772-2, ukupne površine 7342m², deo parcele br. P-71813006-771-3, ukupne površine 1274m², deo parcele br. P-71813006-771-2, ukupne površine 1469m², deo parcele br. P-71813006-00771-1, ukupne površine 1223m², deo parcele br. P-71813006-10, ukupna površina od 106m², deo parcele br.P-71813006-00783-0, u ukupnoj površini 276m², katastarska zona Vlašnje, Opština Prizren, koja je nakon eksproprijacije konačnom odlukom br.09 / 128 od 11. 6. 2010 i rešenjem br. 06/12 od 27. 4. 2011 od Vlade Republike Kosovo, delovi katastarskih parcela, u vlasništvu Vlade Republike Kosovo - Ministarstva infrastrukture i saobraćaja sa sedištem u Prištini, daju se pod zakup samo u komercijalne svrhe. Kao i deo parcele br. P-71813023-00173-1, ukupne površine 5471m², deo parcele br. P-71813023-00177-2, ukupne površine 9399m², deo parcele br. P-71813023 -00177-1, ukupna površina 7964m², deo parcele br. P-71813023-00178-2, ukupna površina 3224m², deo parcele br. P-71813023-00181-1, ukupna površina 5471m², deo parcele br. P-71813023-00179-0, ukupne površine 6493m², deo parcele br. P-71813023-00180-0, ukupne površine 2676m², deo parcele br.P-71818023 -00181-1, ukupna površina 2126m², deo parcele br. P-71813023-00181-01, ukupna površina 263m², deo parcele br. P-71813023-00171-2, ukupna površina 4144m², br. Parcele br. P-71813023-00171-4, u ukupnoj površini od 1604m², parcela br. P-71813023-00171-1, u ukupnoj površini 7246m², katastarska zona Dušanovo, opština Prizren, koja je nakon eksproprijacije konačnom odlukom br. 09 / 128 od 11. 6.2010 i rešenjem br.06 / 12 od 27. 4. 2011. godine Vlade Republike Kosovo, delovi katastarskih parcela u vlasništvu Vlade Republike Kosovo - Ministarstva za infrastrukturu i saobraćaj sa sedištem u Prištini, daju se u zakup samo za komercijalne svrhe.

### Potrebna dokumentacija:

- Sertifikat o registraciji poslovanja;
- Informacije o poslovnom registru;
- Sertifikat o PDV;
- Sertifikat Fiskalnog broja;
- Ekonomski plan investicija sa opštim opisom o poslovnoj delatnosti u poljoprivrednom zemljištu pod zakup, u kojem se određuju poslovne aktivnosti, kao i uticaj delatnosti u povećanju broja zaposlenih;
- Trajanje korišćenja zemljišta u zakupu, zavisno od poslovnih aktivnosti;
- Potvrdu da nema ne izmirenih finansijskih ili pravnih obaveza prema državi;
- Visinu ponuđene cene za zakup poljoprivrednog zemljišta;
- Početna cena godišnji 0.30 cent za m²;
- Bankarska garancija za osiguranje ponude u vrednost zakupa.

### Kriterijumi:

- Pravo na apliciranje imaju fizička i pravna lica, domaća i strana;
- Vreme korišćenja poljoprivrednog zemljišta datog na zakup je dvadeset (20) godina, sa mogućnošću produženja;

**Datum objavljivanja:** 15. 10. 2019
**Datum zatvaranja:** 14. 11. 2019

### Dokumentacija:

- Zahtev u pisanoj formi popunjen i potpisan od strane ponuđača, kao i protokoliran u Kosovskom institutu poljoprivrede u Peći;
- Lična karta;
- Bankovna kartica.

Dokumenta treba da budu fotokopirani, jer se ista ne vraćaju.

**Procedure apliciranja:** Apliciranje za uzimanje zemljišta pod zakup dostavljaju se Ministarstvu Infrastrukture i Transporta, Trg Majke Tereze.

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIC OF KOSOVO/REPUBLIKA KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS/GOVERNMENT OF KOSOVA/ VLADA KOSOVA

MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE- MINISTRY OF CULTURE, YOUTH AND SPORTS-MINISTARSTVO ZA KULTURU, OMLADINU I SPORTA

## NJOFTIM PËR ANULIMIN E KONKURSIT

Bazuar në vendimin e KZKA-së, Nr. 21/2019 të datës 26.09.2019, me Nr. Protokoli 4109/2019, të datës 26.09.2019, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, bënë njoftimin për anulimin e konkursit të rishpallur me datë 07.08.2019, për pozitën Inspektor në Inspektoratin e Trashëgimisë Kulturore.

## OBAVEŠTENJE O ANULIRANJU KONKURSA

Na osnovu odluka KRPŽ, Br. 21/2019, datuma 26.09.2019, sa Br.Protokola 4109/2019, datuma 26.09.2019, Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta, obaveštava o anuliranju, ponovno obavljenog konkursa datuma 12.07.2019, za poziciju Inspektor Inspektoriata za Kulturnu Baštinu.

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIC OF KOSOVO/REPUBLIKA KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS/GOVERNMENT OF KOSOVA/ VLADA KOSOVA

MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE- MINISTRY OF CULTURE, YOUTH AND SPORTS-MINISTARSTVO ZA KULTURU, OMLADINU I SPORTA

NJOFTIM PËR ANULIMIN E KONKURSIT

Bazuar në vendimin e KZKA-së, Nr. 25/2019 të datës 09.10.2019, me Nr. Protokoli 4272/2019, të datës 09.10.2019, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, bënë njoftimin për anulimin e konkursit të shpallur me datë 12.07.2019, për pozitën Zyrtar per Buxhet dhe Finance ne MKRS Prizren.

OBAVEŠTENJE O ANULIRANJU KONKURSA

Na osnovu odluka KRPŽ, Br. 25/2019, datuma 09.10.2019, sa Br.Protokola 4272/2019, datuma 09.10.2019, Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta, obaveštava o anuliranju konkursa obavljenog datuma 12.07.2019, za Poziciju Zvanicnik za Buđet i Financije u MKOS Prizren.




RESTAURANT
SWISS
TAVERNA
Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553
Prishtinë



**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
***Qeveria - Vlada - Government***
*Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit*
*Ministarstvo Infrastrukture i Transporta*
*Ministry of Infrastucture and Transportation*

# NJOFTIM

Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit njofton për anulimin e shpalljes publike me titull: "Shpallja Publike për Dhënjen e Tokës me Qira", e publikuar me datë 11.09.2019 në veb faqen zyrtare të MIT dhe në gazetën ditore "Epoka e re".

**Njoftimi për shprehje të interesit**

Emri i shkollës: **"Nefit Jusufi" -Skorobisht**
Komuna: **Prizren**
Data:**16.10. 2019**
Emri i kontratës:**Blerja e mjeteve te teknologjisë**
Numri i kontratës: ESIP/SDG/088 – G/1.2

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e *projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit* (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe Shkollën **"Nefit Jusufi"Skorobisht, Prizren**. Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi si në vijim i pajisjeve të nevojshme:

1. Përshkrimi i mallrave të nevojshme:
 - Llaptop– 4 copë
 - Projektor– 1 copë

2. Kriteret minimale për kualifikim të kontraktuesve që mund të aplikojnë janë:
   - Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e së paku 1 kontrate për ofrimin e mallrave të natyrës së ngjashme në vitin e fundit.
   - Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.

3. Kontraktuesit e interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhur të aplikojnë me shprehjet e tyre të interesimit kundrejt specifikimit të hollësishëm teknik në adresën SHFMU "**Nefit Jusufi" -Skorobisht, Prizren**. më së largu deri më **24.10.2019**

4. Specifikimi i hollësishëm teknik së bashku me afatet dhe kushtet e tjera, ku të gjitha janë të përgatitura në kuadër të një dokumenti të quajtur Ftesë për ofertë-mallra do t'ia dorëzojë shkolla vetëm atyre kontraktuesve potencialë që i plotësojnë kriteret. Kompanitë luten që t'i shkruajnë detajet kontaktuese me rastin e shprehjes së interesit.
Detajet kontaktuese të shkollës:

Detajet kontaktuese të shkollës:

**Personi kontaktues: Ramit Jusufi**
**Telefoni: 044 621-341**
**E-maili: shfmunefitjusufi@gmail.com**

## NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se "PRO COMSULTING" L.L.C, ka marrë vendim të shuajë biznesin me numër: NRB. Biznesit dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë Kooperativë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

## OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "PRO COMSULTING" L.L.C, donelo odluku o prestani rada sa bisnisom : NRB. Biznesit: 70827948 ujedno imenovao Likvidatora o sprovodjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

## ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the "PRO COMSULTING" L.L.C, has come to the decision to quit its business: NRB. Biznesit: 70827948 The company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

## NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se "BUSIMESS & LAW CONSULTING,L.L.C, ka marrë vendim të shuajë biznesin me numër NRB: 70584204 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë Kooperativë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

## OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "BUSIMESS & LAW CONSULTING" L.L.C, donelo odluku o prestani rada sa bisnisom NRB: 70584204 ujedno imenovao Likvidatora o sprovodjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

## ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the "BUSIMESS & LAW CONSULTING" L.L.C, has come to the decision to quit its business NRB: 70584204 The company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se "MEAR SOLUTIOMES", SH.P.K, ka marrë vendim të shuajë biznesin me numër NRB: 71002012 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë Kooperativë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "MEAR SOLUTIOMES" D.O.O, donelo odluku o prestani rada sa bisnisom NRB: 71002012 ujedno imenovao Likvidatora o sprovodjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the "MEAR SOLUTIOMES " L.L.C, has come to the decision to quit its business NRB: 71002012 The company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se "MEAR CONSTRUCTION", SH.P.K, ka marrë vendim të shuajë biznesin me numër NRB: 71001911 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë Kooperativë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "MEAR CONSTRUCTION " D.O.O, donelo odluku o prestani rada sa bisnisom NRB: 71001911 ujedno imenovao Likvidatora o sprovodjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the "MEAR CONSTRUCTION " L.L.C, has come to the decision to quit its business NRB: 71001911 The company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

▶ Gazmend Selmani shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën e shkollës së mesme të gjimnazit "Sami Frashëri" në Prishtinë.

▶ Ecovis SH.P.K. shpallë të pavlefshme certifikatën e regjistrimit të biznesit me nr. 810845795

▶ Fjolla Gashi shpall te pa vlefshme dëftesat e viteve X,XI,XII dhe diplomën e Gjimnazit "Asllan Berisha" në Rogovë KK Gjakovë.

▶ Fisnik Krasniqi shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën shme "Ymer Prizreni" Prizren.

▶ Fisnik Krasniqi shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - lX shf "Mustafa Bakiu" Prizren.

▶ Illner Jusufi shpall te pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi" Prizren.

▶ Gramoz Rexhaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - Vlll shf "Dëshmorët e Kabashit" Korish.

▶ Bledion Gashi shpall te pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi" Prizren.

▶ Kastrija Halimi shpall te pavlefshme certifikatën shmlt "11 Marsi" Prizren.

▶ Baki Gashi shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIll shf "Luigj Gurakuqi" Nashec.

▶ Lëshoj banesë me qera në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 €uro. Tel: 044-185-233.

▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

▶ Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

▶ Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

▶ Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

▶ Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

▶ Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

▶ Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

▶ Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

▶ Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

▶ Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.

▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen "Ulpiana" në Prishtinë, afër AAK-së. Banesa është e mobiluar komplet. Për informata mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 044-162-783, si dhe në të njëjtin numër në viber.

▶ Kërkojmë 4 bashkëbanuese, studente, banesa gjendet te Parku i qytetit, kati i I-rë, ka 3 dhoma, banjo , ballkon, çmimi për person është 50 euro plus shpenzimet . Për info: 045/699-221.

▶ Lëshohet me qira banesa në lagjen Bregu i Diellit te furra Qërimi 2. Banesa është në katin e tretë, ka sallon dhe kuzhinë si dhe dy dhoma të fjetjes. Numri i telefonit: 044 332 640.

▶ Lëshohet banesa me qira në Prishtinë në lagjen "Ulpiana", afër AAK-së. Për informata lajmërohuni në tel: 044/162-783

▶ Lëshoj banesë me qira në Ulpianë, tek Fontana në: E 30-3A, nr.27, kati -IV-. Çmimi sipas marrëveshjes në info: 044-132-368.

▶ Kërkoj dy bashkëbanuese, mundësisht të cilat janë duke punuar. Banesa gjendet në qendër të qytetit në Prishtinë përball Prokurorisë së shtetit (ish-ndërtesa e OSBE-së, ose ish-ndërtesa e Bankës së Lubjanës), rruga "Hajdar Dushi", afër shtabit kryesor të Policisë së Kosovës. Banesën mund ta shiheni çdo ditë. Numri i telefonit: 049/402-518.

▶ Shesim banesën dy dhomëshe në Ulpiana D8 h3 Nr 15 kati 3 ndërtim i vjetër, e rinovuar komplet, me nxemje të qytetit , çmimi 77 000€. Informatat tel:049/400-958 dhe 044/627-387


MEKA
HALAL FOOD
pashtetë pule
gluten free
100 % mish pule
cilësi e garantuar
pa konservues


ROYAL CROWN
RC cola
ANNOUNCING THE 2017
QUALITY & SALES AWARDS
Quality & Sales Award Recipients
(Listed in alphabetical order)
★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
★ Embotelladaora Central S.A Paraguay, Quality
★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Qualtiy
★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales
RC cola
Columbus, Georgia, USA
RC cola
0.5L